



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 136

Tiranë – E martë, 30 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 26.6.2026	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës të pasurisë me numër 101/2, zona kadastrale 3541, dhe për një shtesë në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit”, të ndryshuar..... 12373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 26.6.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 518, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar..... 12375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 26.6.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë”, të ndryshuar..... 12376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 473, datë 26.6.2026	Për përcaktimin e rregullave për kryerjen e verifikimeve kufitare të përbashkëta..... 12376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 26.6.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 12380
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 26.6.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti arkitektonik i rrugëve “Myslym Gjoleka”, “Ahmet Lepenica”, “Hysni Muka”, në lagjen “Kushtrimi”, Bashkia Vlorë..... 12397

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 26.6.2026	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për projektin e vlerësimit të dëmeve në ndërtesa, një fazë e vetme, 2025–2029.....	12399
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 26.6.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 608, datë 23.10.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugës ‘Kujtim Laro’ dhe ‘Kongresi i Manastirit’, Bashkia Tiranë’”.....	12413
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 26.6.2026	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkitë Kurbin dhe Lezhë.....	12414
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 26.6.2026	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë e Kurbin, dhe caktimin e bashkive Krujë e Kurbin si njësi zbatuese.....	12414
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 26.6.2026	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për objektet me shkallë dëmtueshmërie DS4 në Bashkinë Kurbin.....	12415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 26.6.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar”, të ndryshuar.....	12415
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 484, datë 26.6.2026	Për një shtesë në vendimin nr. 980, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e projektimit, zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të Qendrës së Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”, të ndryshuar.....	12416
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 26.6.2026	Për një shtesë në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall”, të ndryshuar.....	12416
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 26.6.2026	Për administrimin dhe përdorimin e fondit të posaçëm të krijuar nga veprimtaritë e lojërave të fatit.....	12417
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 26.6.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 31, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2026, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”.....	12418

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 491, datë 26.6.2026	Për përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Bordit të Inspektimeve.....	12419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 493, datë 26.6.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, të ndryshuar.....	12422
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 26.6.2026	Për një shtesë në vendimin nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier”, të ndryshuar.....	12425
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 398, datë 3.6.2026	Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës së mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet platformës elektronike.....	12426
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 91, datë 2.4.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “Dion Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	12438
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 95, datë 2.4.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.....	12439
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 2.4.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k.....	12441
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 2.4.2026	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.....	12443
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 12.6.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	12444
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 167, datë 15.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Doma Group” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	12446
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 168, datë 15.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Global Interprise Group” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	12448
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 169, datë 15.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	12449
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 170, datë 15.6.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	12450

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 171, datë 15.6.2026	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Këlcyrë 2020’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Klisyrë’, me kapacitet prodhues 2 mw”	12452
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 172, datë 15.6.2026	Mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k.....	12454

**VENDIM****Nr. 468, datë 26.6.2026**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI
TË BASHKISË DURRËS TË PASURISË
ME NUMËR 101/2, ZONA KADASTRALE
3541, DHE PËR NJË SHITESË NË
VENDIMIN NR. 536, DATË 1.5.2008, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS
PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË DURRËS, TË QARKUT TË
DURRËSIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës të pasurisë me numër 101/2, me vendndodhje në zonën kadastrale 3541, sipas formularit dhe planit

të rlevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur për interes vendor, në funksion të Qendrës së Strehimit dhe Trajtimin për Kafshët.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi i shtohet listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit”, të ndryshuar.


3. Bashkisë Durrës i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Durrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI SHTET		DATE 10/12/2025		QELLIMI PER TRANSFERIM																																				
VENDNDODHJA BASHKIA DURRËS DVASHK DURRËS ZONA KADASTRALE 3541 NUMRI I PASURISË 101/2 INDEKSI I HARTËS K-34-88 (209-D)																																								
TË DHËNAT E PASURISË LLOJI I PASURISË: TRUALL SIPËRFAQJA E PASURISË = 1664 m ² ZONA KADASTRALE 3541 NUMRI I KATEVE NUMRI I PEMËVE																																								
X 459698.1345 Y 4583495.0713 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X 460387.5204 Y 4583495.0713																																								
																																								
SH 1:2500																																								
X 459698.1345 Y 4583072.2719 X 460387.5204 Y 4583072.2719																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"><thead><tr><th>Nr.</th><th>ORIENTIMI</th><th>PERDORIMI</th><th>TIPI KUFIRIT</th><th>KUFITARI</th><th>ID/NIPT</th><th>SHENIME TE REALIZUESIT</th></tr></thead><tbody><tr><td>1</td><td>V-</td><td></td><td></td><td>291</td><td></td><td></td></tr><tr><td>2</td><td>L-</td><td></td><td></td><td>297</td><td></td><td></td></tr><tr><td>3</td><td>J-</td><td></td><td></td><td>101/3</td><td></td><td></td></tr><tr><td>....</td><td>P-</td><td></td><td></td><td>101/1</td><td></td><td></td></tr></tbody></table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	V-			291			2	L-			297			3	J-			101/3				P-			101/1		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	V-			291																																				
2	L-			297																																				
3	J-			101/3																																				
....	P-			101/1																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"><tr><td style="width: 50%; vertical-align: top; padding: 5px;">REALIZOI PËR BASHKINË DURRËS PUNOI: FATJON ZEIQIRI ANILA MUHJA NËNSHKRIMI:  PERGJEGJES: JETMIR PUPLA NËNSHKRIMI:  DREJTORI: ALNEIDA RROSHI NËNSHKRIMI:  ZEVENDESKRYETAR: GENTIAN KALLI NËNSHKRIMI/VULA:  REALIZOI PËR DVASHK SPECIALISTI: NËNSHKRIMI: KONFIRMOI PERGJEGJES/DREJTORI: _____ NËNSHKRIMI/VULA: _____</td><td style="width: 50%; vertical-align: top; padding: 5px;">TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjiine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Ky plan rilevimi është hartuar me qëllim transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës të pas. nr. 101/2, e llojit Truall, me sip.1634 m², me vendodhje në ZK 3541. Aktualisht në këtë truall është ngritur një ndërtesë me sip.102 m², sipas lejes së ndërtimit nr. 1149-24/5, datë 11.03.2025. Objekti ka destinacion "Qendër e trajtimit të kafshëve të rrugës, për të cilën është kërkuar dhe transferimi. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NËNSHKRIMI: _____</td></tr></table>						REALIZOI PËR BASHKINË DURRËS PUNOI: FATJON ZEIQIRI ANILA MUHJA NËNSHKRIMI:  PERGJEGJES: JETMIR PUPLA NËNSHKRIMI:  DREJTORI: ALNEIDA RROSHI NËNSHKRIMI:  ZEVENDESKRYETAR: GENTIAN KALLI NËNSHKRIMI/VULA:  REALIZOI PËR DVASHK SPECIALISTI: NËNSHKRIMI: KONFIRMOI PERGJEGJES/DREJTORI: _____ NËNSHKRIMI/VULA: _____	TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjiine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Ky plan rilevimi është hartuar me qëllim transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës të pas. nr. 101/2, e llojit Truall, me sip.1634 m ² , me vendodhje në ZK 3541. Aktualisht në këtë truall është ngritur një ndërtesë me sip.102 m ² , sipas lejes së ndërtimit nr. 1149-24/5, datë 11.03.2025. Objekti ka destinacion "Qendër e trajtimit të kafshëve të rrugës, për të cilën është kërkuar dhe transferimi. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NËNSHKRIMI: _____																																	
REALIZOI PËR BASHKINË DURRËS PUNOI: FATJON ZEIQIRI ANILA MUHJA NËNSHKRIMI:  PERGJEGJES: JETMIR PUPLA NËNSHKRIMI:  DREJTORI: ALNEIDA RROSHI NËNSHKRIMI:  ZEVENDESKRYETAR: GENTIAN KALLI NËNSHKRIMI/VULA:  REALIZOI PËR DVASHK SPECIALISTI: NËNSHKRIMI: KONFIRMOI PERGJEGJES/DREJTORI: _____ NËNSHKRIMI/VULA: _____	TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjiine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: Ky plan rilevimi është hartuar me qëllim transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës të pas. nr. 101/2, e llojit Truall, me sip.1634 m ² , me vendodhje në ZK 3541. Aktualisht në këtë truall është ngritur një ndërtesë me sip.102 m ² , sipas lejes së ndërtimit nr. 1149-24/5, datë 11.03.2025. Objekti ka destinacion "Qendër e trajtimit të kafshëve të rrugës, për të cilën është kërkuar dhe transferimi. PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI: _____ NËNSHKRIMI: _____																																							
Kode per teknologjiine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Station Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia / Komuna : Durres		Identifikoi: Fatjon Zeqiri (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)	
Fusha e perdorimit te Prones: Prona qe perdoren ne fushen e bujqesise dhe ushqimit " Interes Vendor"		Per Zyren e Pronave : Anila Muhja (Specialist) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)	
(Qender e trajtimit te kafshëve e ruges)		Supervizori: Jetmir Pupla (Pergj. Sek. Pronave) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)	
		Aneida Rroshi Drejtoria Ligjore (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)	
		Aprovoi: Gentian Kalimi Zevendeskrjetar i Bashkise (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)	

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	B		C				
				Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndetese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik perdorimit	Te dhena tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3541 K-34-88-(209-D)	101/2	Truall	Qender strehimi dhe trajtimi per kafshet Bashkia Durres	1634 m2		Interes vendor	Bashkia Durres	Bashkia Durres	Mbi truallin eshte ndertuar objekti me Leje Nd. nr.1149-24/5 dt.11.03.2025 ngritur objekt 2 kate " Qender strehimi dhe trajtimi per kafshet"

VENDIM**Nr. 470, datë 26.6.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 518, DATË 20.9.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË TË NJË PJESE TË
GODINËS, KU USHTRON
VEPRIMTARINË KONTROLLI I LARTË
I SHTETIT, PËR KOLEGJIN E
POSAÇËM TË APELIMIT DHE
PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 518, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i

Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në titullin e vendimit dhe kudo në përmbajtje të tij, emërtimi "Kolegjit të Posaçëm të Apelit" zëvendësohet me "Gjykatës Kushtetuese".

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Gjykata Kushtetuese do të përdorë mjediset sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve."

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi**



VENDIM

Nr. 471, datë 26.6.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 910, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË OPERACIONIN
USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR,
KOSOVË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi “... 10 (dhjetë) ...” zëvendësohet me “... 12 (dymbëdhjetë) ...”;

b) Në pikën 4, togfjalëshi “... çdo 6 (gjashtë) muaj ...” zëvendësohet me “... deri në 6 (gjashtë) muaj ...”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2026.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu**

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes

VENDIM

Nr. 473, datë 26.6.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE
KUFITARE TË PËRBASHKËTA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Verifikimet kufitare në pikat e kalimit kufitar kryhen sipas parimit “një ndalesë-një verifikim”, që nënkupton se çdo person, mjet apo mall i nënshtrohet një kontrolli të plotë dhe të koordinuar nga të gjitha autoritetet përgjegjëse vetëm një herë në pikën përkatëse të kalimit kufitar, me qëllim lehtësimin e kalimit dhe sigurimin e një verifikimi sa më efektiv.

2. Mosprezenca e një autoriteti të caktuar gjatë verifikimit kufitar të vijës së parë nuk kushtëzon apo nuk pengon autoritetet e tjera, që, në përputhje me kompetencat e tyre, të kryejnë verifikimin kufitar.

3. Çdo element verifikimi i vijës së parë, për llogari të çdo autoriteti, i cili ka nevojë për verifikim, inspektim apo ekzaminim të mëtejshëm, që nuk mund të kryhet për një kohë të shkurtër në zonën e vijës së parë, konsiderohet arsye për verifikim të vijës së dytë.

4. Gjatë verifikimeve të vijës së dytë, çdo autoritet i pranishëm në kufi, që ka kompetenca dhe detyrime në lidhje me natyrën e verifikimit në fjalë, ka detyrimin të marrë pjesë në verifikim, përveç rasteve kur nga kjo prani rrezikohen hetimet për një vepër penale, identiteti i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur ose informacioni i klasifikuar.

5. Autoritetet përgjegjëse, që operojnë në pikën e kalimit kufitar, përdorin ose shfrytëzojnë bashkërisht pajisjet, mjetet dhe mjediset e

kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 77, datë 23.3.2016, faqe 1–52.



verifikimit kufitar, veçanërisht të vijës së dytë, pavarësisht nga pronësia e këtyre pajisjeve apo mjediseve. Ky rregull zbatohet edhe në rastin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar.

6. Në verifikimet e vijës së dytë, kur nevojitet ekspertizë profesionale në tërësi ose për elemente të veçanta verifikimi, veprimet e drejtpërdrejta, në lidhje me këto elemente kryhen nga punonjësit e atij autoriteti që ka ekspertizën përkatëse ose nga një ekspert i jashtëm në rastet kur asnjë autoritet nuk ka punonjës me ekspertizë në këto fusha.

7. Për verifikimet kufitare të vijës së dytë, në të cilat, për arsye kompetence apo të natyrës specifike të kontrollit, kërkohet pjesëmarrja e një autoriteti që nuk vepron në kufi ose që vepron me orar të kufizuar, njoftohet autoriteti përkatës nëpërmjet komunikimit telefonik, postës elektronike, shërbimit postar ose faksit.

8. Mosparaqitja brenda një kohe të arsyeshme e autoritetit të njoftuar sipas parashikimit të pikës 7, të këtij vendimi, nuk kushtëzon moskryerjen e verifikimit kufitar, përveç rasteve kur prania e autoritetit kompetent është absolutisht e domosdoshme.

9. Verifikimet e kryera nga Policia Kufitare dhe Migracionit në brendësi të territorit, në kuptim të nenit 7, të ligjit nr. 39/2025, “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, kryhen, sipas rastit, në koordinim dhe bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse kompetente, kur gjatë verifikimit evidentohen elemente që, sipas legjislacionit në fuqi, bëjnë pjesë në fushën e përgjegjësive të tyre.

10. Për verifikimet e parashikuara në pikën 9, të këtij vendimi, në rastet kur kontrolli është objekt i kompetencës së autoriteteve të tjera përgjegjëse, njoftohen shërbimet më të afërta të autoritetit përkatës nëpërmjet komunikimit telefonik, postës elektronike, shërbimit postar ose faksit, me qëllim kryerjen e verifikimeve sipas legjislacionit në fuqi, përveç rasteve kur nga vonesa mund të rrezikohen jeta dhe siguria e njerëzve, hetimet penale, identiteti i viktimave ose viktimave të mundshme të trafikimit, identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur ose informacioni i klasifikuar.

11. Në çdo rast të kryerjes së verifikimeve apo kontrolleve të përbashkëta, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, përfaqësuesit e autoriteteve përgjegjëse pjesëmarrëse kanë detyrimin të

nënshkruajnë aktin përkatës të konstatimit, verifikimit apo kontrollit.

12. Në rastin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, pavarësisht nga territori ku ato ndodhen, autoritetet përgjegjëse shqiptare mund të kryejnë verifikime të përbashkëta kufitare me autoritetet përgjegjëse fqinje, në përputhje me marrëveshjen përkatëse dhe duke respektuar:

a) aksesin në mbrojtjen ndërkombëtare, sipas ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, për personat që kërkojnë këtë mbrojtje, në çdo kohë, kur pika e përbashkët e kalimit kufitar gjendet në territorin shqiptar dhe në momentin që ka përfunduar procedurat e daljes nga vendi fqinj, kur pika e përbashkët gjendet në territorin e vendit fqinj;

b) shkëmbimin e informacionit të nevojshëm dhe informimin e saktë të palëve në lidhje me faktet dhe provat, në rastin e çështjeve që justifikojnë ndalimin apo arrestimin e një personi ose bllokimin e një sendi, si dhe transferimin e personit ose sendit të pala që ndjek çështjen, pavarësisht nga shtetësia e personit ose vendi i regjistrimit të sendit;

c) mospengimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të personit që gëzon këtë të drejtë, pavarësisht nga ekzistenca e motiveve për refuzim daljeje nga pala tjetër, kur në legjislacionin e kësaj pale ekziston një parashikim për këtë dhe shkëmbimin e informacionit mbi këto motive për të mundësuar një trajtim të përshtatshëm të rastit;

ç) vendosjen dhe përdorimin e përshtatshëm të sistemeve elektronike dhe bazave të të dhënave, duke ruajtur të dhënat personale nga dëmtimi ose humbja aksidentale apo e paligjshme, nga modifikimi, dekonspirimi ose aksesit i paautorizuar i tyre, përfshi këtu aksesin nga shtetet që nuk e gëzojnë këtë të drejtë.

13. Për kryerjen në mënyrë të efektshme të verifikimeve të përbashkëta kufitare, pikat e kalimit kufitar pajisen përkatësisht me mjediset, mjetet dhe pajisjet, si më poshtë vijon:

a) Pikat e kalimit kufitar për qarkullim ndërkombëtar të personave pa automjete pajisen, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Pikat e kalimit kufitar për qarkullim ndërkombëtar të personave dhe automjeteve jo të rënda pajisen, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, që i



bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

c) Pikat e kalimit kufitar për qarkullim ndërkombëtar të mjeteve dhe mallrave pajisen, minimalisht, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

14. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministritë dhe autoritetet e tjera që kanë kompetenca dhe detyrime në lidhje me kufirin shtetëror, sipas përcaktimeve të bëra në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe planin e saj të veprimit, marrin masa për pajisjen e pikave të kalimit kufitar me mjediset, mjetet dhe pajisjet, në përputhje me shtojcat përkatëse të këtij vendimi, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse të tyre apo të secilit institucion të varësisë, që vepron në pikën e kalimit kufitar, duke i konsideruar ato si kritere standarde minimale.

15. Për çështje të veçanta të aspekteve teknike, procedurale dhe organizative të verifikimit të përbashkët kufitar, të cilat kanë nevojë për specifikime konkrete të veprimtarisë së dy a më shumë autoriteteve, ministrat e linjës nxjerrin urdhër të përbashkët në zbatim të këtij vendimi.

16. Për çështje të veçanta të aspekteve teknike, procedurale dhe organizative të verifikimit kufitar, të cilat kanë nevojë për specifikime konkrete të veprimtarisë së strukturave vartëse të ministrive të linjës, ministri përkatës nxjerr urdhër në zbatim të këtij vendimi.

17. Veprimet dhe mënyra e bashkëpunimit të strukturave të Policisë së Shtetit ndërmjet tyre për verifikimin e përbashkët kufitar përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

18. Veprimet e Policisë Kufitare dhe Migracionit gjatë verifikimit kufitar kryhen, në përputhje me procedurat standarde të punës, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, duke u mbështetur edhe në manuale teknike apo udhëzues operacionale, me qëllim zbatimin e praktikave më të mira për kryerjen e verifikimeve të efektshme.

19. Vendimi nr. 745, datë 26.10.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për kryerjen e

verifikimeve të përbashkëta kufitare”, shfuqizohet.

20. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi

SHTOJCA NR. 1
AMBIENTET, MJETET DHE PAJISJET, TË
NEVOJSHME NË PKK-të E PËRCAKTUARA
PËR QARKULLIM NDËRKOMBËTAR TË
PERSONAVE, PA AUTOMJETE

1. Ambiente:

- objekt me infrastrukturë të përshtatshme komunikacioni, telekomunikacioni, akomodimi dhe ndriçimi, i mbështetur me gjenerator të përshtatshëm energjie;

- ambiente zyre për shërbimet e autoriteteve përgjegjëse që operojnë në pikën e kalimit kufitar;

- ambiente të përshtatshme për qarkullimin dhe verifikimin e personave në vijën e parë;

- dhomë intervistimi dhe kontrolli personal;

- dhomë për ndalim personash (të ndara sipas gjinisë);

- dhoma për të kthyerit/të riatdhesuarit dhe azilkërkuesit (të ndara sipas gjinisë);

- depo për armatimin;

- vendparkim për automjete zyrtare.

2. Pajisje tekniko-policore dhe pajisje të tjera speciale, si në vijim:

- lente *portable* për verifikim dokumentesh;

- burim drite ultraviolet *portable* për verifikim dokumentesh;

- burim drite të bardhë *portable* për verifikim dokumentesh;

- pajisje stacionare për verifikimin e pasaportave me lente, me burim drite të bardhë dhe me burim drite UV;

- dritë dore;

- krahasues videospektral për dokumente;

- pajisje *portable* për verifikimin/matjen e radioaktivitetit;



- mikroskop për verifikim dokumentesh në vijën e dytë;

- laborator *portable* për ekzaminimin e dokumenteve në vijën e dytë;

- skaner i gjurmëve të gishtave;

- aparat fotografik digjital;

- videokamera digjitale;

- matës alkooli;

- komplete testi *portable* për zbulimin e drogave dhe eksplozivëve;

- sistem videosurvejimi për sistemin e sigurisë në PKK (CCTV).

3. Pajisje zyre:

- diktofonë;

- *fax (laser fax)*;

- printer;

- skaner;

- fotokopje;

- videoregjistrues;

- televizorë;

- videoprojektor.

4. *Hardware* dhe *software* për kompjuterizimin e sistemit të verifikimit kufitar:

- stacione pune (kompjuter i lidhur në rrjet) të standardit profesional me burim të pandërprerë energjie;

- lexues stacionar/*portable* dokumentesh;

- pajisje *portable* për mbledhjen, krahasimin dhe verifikimin e të dhënave;

- servera komunikimi me burim të pandërprerë energjie;

- servera të bazave të të dhënave me burim të pandërprerë energjie;

- servera qendrorë për procesimin e bazave të të dhënave me burim të pandërprerë energjie;

- baza të dhënash për verifikimin optimal të personave në vijën e parë dhe të dytë.

SHTOJCA NR. 2

AMBIENTET, MJETET DHE PAJISJET,

TË NEVOJSHME NË PKK-të E

PËRCAKTUARA PËR QARKULLIM TË

PERSONAVE ME AUTOVETURA DHE

AUTOMJETE TË TJERA JO TË RËNDA

1. Ambiente:

- ambiente të përshtatshme për qarkullimin dhe verifikimin e personave dhe automjeteve jo të rënda në vijën e parë;

- ambient i veçantë për inspektimin fizik të automjeteve në vijën e dytë;

- ambient për sendet dhe mallrat e bllokuara/të sekuestruara që transportohen në automjete jo të rënda;

- hapësirë/ambient për parkimin dhe ruajtjen e automjeteve të bllokuara;

- dhomë mbledhjesh/prezantimesh.

2. Pajisje tekniko-policore dhe pajisje të tjera speciale, si në vijim:

- pasqyrë për inspektimin e mjeteve të transportit nga poshtë gjatë verifikimit të vijës së parë;

- minilaborator për verifikimin e dokumenteve të personave dhe automjeteve në vijën e dytë;

- pajisje për zbulimin e sipërfaqeve johomogjene/me ndryshim të strukturës origjinale;

- pajisje për matjen e dendësisë së gomave të automjeteve;

- pajisje videooptike për inspektimin e sarbatorëve të karburantit;

- pajisje videooptike për inspektimin e hapësirave boshe të automjeteve dhe të sendeve;

- komplete pajisjesh profesionale për zbërthim e mbërthim të automjeteve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre;

- pajisje *portable* për zbulimin e radioaktivitetit gjatë verifikimit të vijës së dytë;

- pajisje për ndriçim të mjaftueshëm gjatë inspektimit të automjeteve.

3. *Hardware* dhe *software* për kompjuterizimin e sistemit të verifikimit kufitar, si në vijim:

- baza të dhënash për verifikimin optimal të personave dhe automjeteve në vijën e parë dhe të dytë;

- stacione pune (kompjuter i lidhur në rrjet) të standardit profesional me burim të pandërprerë energjie në ambientet e verifikimit të automjeteve në vijën e dytë;

- sistem i leximit automatik për targat e automjeteve.



SHTOJCA NR. 3
AMBIENTET, MJETET DHE PAJISJET,
TË NEVOJSHME NË PKK-të E
PËRCAKTUARA PËR QARKULLIM TË
PERSONAVE, AUTOMJETEVE
DHE MALLRAVE

1. Ambiente:

- ambiente të përshtatshme për qarkullimin dhe verifikimin e personave dhe automjeteve jo të rënda në vijën parë;
- ambient magazinimi për mallrat tregtare të bllokuara;
- ambiente për inspektimin e mallrave të natyrës së veçantë (ushqimore, veterinare, bimore);
- ambiente magazinimi për mallrat e natyrës së veçantë të bllokuara/të sekuestruara;
- ambiente të veçanta dhe të përshtatshme për verifikimin kufitar të mjeteve të rënda dhe ngarkesave në to.

2. Pajisje tekniko-policore dhe pajisje të tjera speciale, si në vijim:

- porta stacionere për zbulimin e radiokativitetit;
- sondë/dedektor për matjen e nivelit të CO₂;
- pajisje videooptike për inspektimin e automjeteve të rënda;
- komplete pajisjesh profesionale për zbërthim-mbërthim të automjeteve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre.

3. *Hardware* dhe *software* për kompjuterizimin e sistemit të verifikimit kufitar:

- baza të dhënash për verifikimin optimal të personave, automjeteve dhe mallrave në vijën e parë dhe të dytë;
- stacione pune (kompjuter i lidhur në rrjet) të standardit profesional me burim të pandërprerë energjie në ambientet e verifikimit të automjeteve dhe mallrave në vijën e dytë;
- baza të dhënash të përshtatshme mbi kompanitë e transportit që operojnë me mjete dhe mallra.

VENDIM

Nr. 474, datë 26.6.2026

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN
NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE,
TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 13, të kreut I, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/2469 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/1176 ...”.

2. Në aneksin 13, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/1176, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi



2026/1176

28.5.2026

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2026/1176

i 28 majit 2026

që ndryshon Vendimin (CFSP) 2020/1999 mbi masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti Nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Ndërsa:

- (1) Më 7 dhjetor 2020, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2020/1999 ⁽¹⁾.
- (2) Më 8 dhjetor 2020, me anë të Deklaratës së Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, në emër të Bashkimit Evropian, në lidhje me Regjimin Global të Sanksioneve për të Drejtat e Njeriut të BE-së, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij riafirmuan angazhimin e tyre të fortë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Regjimi Global i Sanksioneve për të Drejtat e Njeriut i BE-së nënvizon vendosmërinë e Bashkimit për të rritur rolin e tij në adresimin e shkeljeve dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut në të gjithë botën. Arritja e gëzimit efektiv të të drejtave të njeriut nga të gjithë është një qëllim strategjik i Bashkimit. Respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut është një vlerë themelore e Bashkimit dhe politikës së tij të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.
- (3) Në përfundimet e tij të 19 marsit 2026, Këshilli Evropian dënoi fuqimisht dhunën e vazhdueshme dhe në rritje të kolonëve kundër civilëve palestinezë dhe përsëriti thirrjen e tij ndaj Këshillit për të çuar përpara punën për masa të mëtejshme kufizuese kundër kolonëve ekstremistë dhe kundër subjekteve dhe organizatave që i mbështesin ata.
- (4) Në këtë kontekst, tre persona dhe katër subjekte duhet të përfshihen në listën e personave fizikë dhe juridikë, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese në Shtojcën e Vendimit (CFSP) 2020/1999.
- (5) Prandaj, Vendimi (CFSP) 2020/1999 duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit (CFSP) 2020/1999 ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 28 maj 2026.

*Për Këshillin**President*

M. DAMIANOS

⁽¹⁾ Vendimi i Këshillit (CFSP) 2020/1999 i 7 dhjetorit 2020 mbi masat kufizuese kundër shkeljeve dhe abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut (OJ L 410 I, 7.12.2020, f. 13, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2020/1999/oj>).



EN

OJ L, 28.5.2026

SHTOJÇË

Shojka e Vendimit (CFSP) 2020/1999 ndryshohet si më poshtë:

(1) shënimet e mëposhtme shtohen në listën e personave fizikë dhe juridikë, entiteteve dhe organeve nën titullin "A. Personat fizikë:

Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
'136. Daniella WEISS	דניאלה וייס (Drejtshtkrimi Hebraik)	Data e lindjes: 30.8.1945 Vendi i lindjes: Benee Brak Palestina e Mandatuar (tani Izrael) Kombësia: Izraelite Gjinia: Femër	Daniella Weiss është Drejtoresha e Lëvizjes Nachala ("Nachala"). Nachala ka për qëllim promovimin e vendbanimeve hebraike dhe post-vendeve të paligjshme në Bregun Perëndimor. Përmes aktiviteteve të saj, Nachala luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe inkurajimin e akteve shtrënguese që çojnë në zhvendosjen me forcë të palestinezëve dhe shkelin të drejtën e tyre për pronë, të drejtën e tyre për jetë private dhe familjare dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, si dhe të drejtën për jetë dhe integritet fizik. Postet e vendbanimeve të Nachala-s, si Evyatar, Maoz Esther, Oz Zion, Ramat Migron, Nachalat Zvi dhe Haeitam Farm, kanë qenë burime të vazhdueshme të dhunës së kolonëve. Disa prej posteve të Nachala-s, përfshirë Yahish Zion, Maoz Esther, Oz Zion dhe Ramat Migron, janë ndërtuar në toka private në pronësi të palestinezëve. Të gjitha postet e Nachala-s pengojnë aksesin e palestinezëve në tokat e tyre bujqësore dhe kulllosore. Për më tepër, pas 7 tetorit 2023, Nachala ka qenë në vijën e parë të përpjekjeve për të rivendosur popullsinë në Rripin e Gazës. Në cilësinë e saj si Drejtoreshe, Daniella Weiss planifikon, drejton dhe mbështet publikisht veprimtaritë e Nachala-s. Për rrjedhojë, ajo është përgjegjëse për lehtësimin dhe nxitjen e shkeljeve dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës, duke përfshirë shkeljet ose abuzimet ndaj të drejtës së palestinezëve për vetëvendosje, të drejtës së tyre të pronësisë, të drejtës për jetë private dhe familjare, si dhe të drejtës për jetën dhe integritetin fizik. Këto çështje përbëjnë shqetësime serioze në lidhje me objektivat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, të përcaktuara në nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026



OJ L, 28.5.2026

EN

	Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
137.	Meir DEUTSCH	מאיר דייטש (Drejshkrimi Hebraik)	Kombësia: Izraelite Gjinia: mashkull	Meir Deutsch është drejtori i përgjithshëm i Regavim, një OJQ izraelite me një axhendë aktive pro-izraelite për kolonët dhe zgjerimin e kolonive në Bregun Perëndimor. Regavim ngre procedura ligjore dhe lobon për prishjen e pronës palestineze me qëllim zgjerimin e kontrollit të Izraelit në të gjithë Bregun Perëndimor. Përmes aktivitetet të saj, Regavim luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe inkurajimin e akteve shtrënguese që synojnë shkatërrimin e pronës palestineze dhe prishjen e shtëpive palestineze, duke çuar në zhvendosjen me forcë të palestinezëve dhe shkelje të së drejtës së tyre për pronë, të drejtës së tyre për jetë private dhe familjare dhe të drejtës së tyre për vetvendosje, si dhe të drejtës së të gjithëve për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor. Regavim është përgjegjës për procedura të shumta gjyqësore dhe ka lobuar për prishjen e një shkolle fillore palestineze, të financuar nga Bashkimi Evropian, në fshatin Jabbet al Dhilb, pranë Betlehemit, në Bregun Perëndimor në maj 2023. Prandaj, në rolin e tij si drejtor i përgjithshëm i Regavim, Meir Deutsch është përgjegjës për lehtësimin dhe inkurajimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Bregun Perëndimor duke përfshirë abuzimet e të drejtës së pronës, të drejtës së jetës private dhe familjare dhe të drejtës së arsimimit të palestinezëve, si dhe të drejtën e të gjithëve për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor, të cilat janë shqetësuese serioze në lidhje me objektivat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të përcaktuara në Nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026



EN

OJ L, 28.5.2026

	Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
138.	Avichai SUISSA	אביחי סויסה (Drejshkrimi Hebraik)	Data e lindjes: 1.7.1986 Kombësia: Izraelite Gjinia: mashkull ID: 038172441	Avichai Suissa është Drejtori Ekzekutiv i Hashomer Yesh, një OJQ izraelite që ofron mbështetje materiale dhe koordinon vullnetarët për punë bujqësore në fermat e bagëtie, duke mbështetur të paktën 28 poste dhe vendbanime të dhunshme në Bregun Perëndimor duke rekrutuar vullnetarë të armatosur dhe duke siguruar roje të përfshira në sulme të dhunshme. Në veçanti, Hashomer Yesh po mbështet postet e themeluara nga individë të listuar nga Bashkimi Evropian: Neria Ben Pazi, themeluese e Postës së Fermës Rimoni; Zvi Bar Yosef, themelues i Fermës Zvi; Yinon Levi, themelues i Fermës Mitari; dhe Moshe Sharvit, themelues i Postës së Fermës Tirza Valley / Ferma Moshe. Prandaj, Avichai Suissa është përgjegjës për lehtësimin dhe inkurajimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Bregun Perëndimor, duke përfshirë abuzimet e të drejtës së pronës së palestinezëve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe të drejtën për integritet fizik dhe mendor, të cilat janë shqetësuese serioze në lidhje me objektivat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të percaktuara në Nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026



OJ L, 28.5.2026

EN

(2) shënimet e mëposhtme shtohen në listën e personave, entiteteve dhe organeve fizike dhe juridike dhe organet juridike:

Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
'38. Amana e njohur edhe si Cooperative Society for Community Settlement Ltd/ Amana – Shoqëri Kooperative për Vendosjen Komunitare Ltd	722X (Drejtitshkrimi Hebraik)	Adresa: Clermont-Ganneau St. 13, Jerusalem Faqja e internetit: https://amanaco.il/ / Data e regjistrimit: 18.2.1979 Numri i regjistrimit: 570025742	Amana është kompania bashkëpunuese e zhvillimit dhe lëvizja e vendbanimeve e lëvizjes Gush Emunim. Që nga krijimi i saj, ajo ka luajtur një rol kyç në iniciimin, financimin dhe lehtësimin e të paktën 30 posteve dhe vendbanimeve të dhunshme, duke përfshirë postet e themeluara nga individë të listuar nga Bashkimi Evropian (Yinon Levi, themelues i Postës së Fërmitës Mitrim; Moshe Sharvit, themelues i Postës së Fërmitës Tzirza Valley / Fërma e Moshes; dhe Isaschar Manne, themelues i postës së Fërmitës Manne) në Bregun Perëndimor të pushuar. Së bashku me dhunën e kolonëve që buronte prej tyre, duke përfshirë edhe kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut, këto poste çuan në zhvendosjen e gjerë të komuniteteve palestineze të cënueshme dhe shpronësimit e pronave palestineze. Përfshirja kryesore e Amanas në këto poste të dhunshme të paligjshme përfshin lehtësimin e blerjes së tokës, ndërtimin dhe tregtimin e shtëpive, iniciimin dhe përgatitjen e planeve master të vendbanimeve dhe financimin e infrastrukturës. Në rastet të ndryshme, organizata dhe menaxhmenti i saj kanë deklaruar qartë objektivat e tyre për shpronësimin e komuniteteve palestineze. Prandaj, Amana është përgjegjëse për lehtësimin dhe inkurajimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Bregun Perëndimor, duke përfshirë abuzimet e të drejtës së pronës së palestinezëve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, të cilat janë shqetësuese serioze në lidhje me objektivat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, siç përcaktohet në nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026



EN

OJ L, 28.5.2026

	Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
39.	Nachala Movement	נחל'ה (Drejtshkrimi Hebraik)	Adresa: Bregu Perëndimor, territoret e pushtuara palestineze Faqja e internetit: https://www.nachalaisrael.org/	Lëvizja Nachala ("Nachala") ka për qëllim promovimin e vendbanimeve hebraike dhe posteve të paligjshme në Bregun Perëndimor. Përmes aktiviteteve të saj, lëvizja luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe inkurajimin e akteve shtrënguese që çojnë në zhvendosjen me forcë të palestinezëve dhe shkelin të drejtën e tyre për pronë, të drejtën e tyre për jetë private dhe familjare dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, si dhe të drejtën për jetë dhe integritet fizik. Postet e Nachala-s, të tilla si Eyyatar, Maoz Esther, Oz Zion, Ramat Migron, Nachalat Zvi dhe Haeitam Farm, kanë qenë burime të vazhdueshme të dhunës së kolonëve. Disa nga këto postet e Nachala-s, duke përfshirë Yahish Zion, Maoz Esther, Oz Zion dhe Ramat Migron, u ndërtuan në tokë palestineze në pronësi private. Të gjitha postet e Nachala-s pengojnë aksesin në tokën bujqësore dhe kullotëse palestineze. Pas 7 tetorit 2023, Nachala ka qenë gjithashtu në ballë të përpjekjeve për të rivendosur Rripin e Gazës. Prandaj, Nachala është përgjegjëse për lehtësimin dhe inkurajimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në Bregun Perëndimor dhe në Rripin e Gazës, duke përfshirë shkeljet e të drejtës së palestinezëve për vetëvendosje, të drejtën e tyre për pronë, të drejtën e tyre për jetë private dhe familjare, si dhe të drejtën për jetë dhe shëndet fizik, të cilat janë shqetësuese serioze në lidhje me objektivat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të përcaktuara në Nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026



OJ L, 28.5.2026

EN

	Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
40.	Regavim, e njohur edhe si Lévi'ija Regavim	רגבים (Drejtshkrimi Hebraik)	Adresa: Rehovot, Mo'din, Jerusalem, Haifa, Maale Adumin, Ariel, Tel Aviv District, Efrat, Bersheeba Faqja e internetit: https://www.regavim.org/ Vendi i regjistrimit: Sha'ar Binyamin PO BOX 44439, Jerusalem, Israel, 9144302	Regavim është një OJQ izraelite me një axhendë aktive pro-izraelite për kolonët dhe zgjerimin e kolonive në Bregun Perëndimor. Regavim ngre procedura ligjore dhe lobon për prishjen e pronave palestineze me qëllim zgjerimin e kontrollit të Izraelit në të gjithë Bregun Perëndimor. Përmes aktivitetëve të saj, Regavim luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe inkurajimin e akteve shtrënguese që synojnë shkatërrimin e pronave palestineze dhe prishjen e shtëpive palestineze, duke çuar në zhvendosjen me forcë të palestinezëve. Regavim është përgjegjës për procedura të shumta gjyqësore dhe ka lobuar për prishjen e një shkolle fillore palestineze, të financuar nga Bashkimi Evropian, në Ishatun Jabbet al Dhilb, pranë Bedlehemit, në Bregun Perëndimor në maj 2023. Prandaj, Regavim është përgjegjës për lehtësimin dhe inkurajimin e abuzimeve me të drejtat e njeriut në Bregun Perëndimor, duke përfshirë shkeljet e së drejtës së pronës, të drejtës për jetë private dhe familjare dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, dhe të drejtën për arsimim të palestinezëve, si dhe të drejtën e të gjithëve për të gëzuar standardin më të lartë të arritshëm të integritetit fizik dhe mendor, të cilat janë shqetësuese serioze në lidhje me objektivat e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të përcaktuara në Nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026



	Emrat (Transliterimi në alfabetin latin)	Emrat	Informacion identifikues	Arsyet për listim	Data e listimit
41.	Hashomer Yosh të njohur edhe si Rojtarët e Judesë dhe Samarisë, Rojtarët e Judesë dhe të Shomronit, Hashomer Judea dhe Samaria, Hashomer Yehudah V'Shomron	הַשׁוֹמְרוֹן (Drejtitshkrimi Hebraik)	Adresa: Esh Kodesh 2, Shilo, 4483000 Bregu Perëndimor, territore të pushtuara palestineze Faqja e internetit: https://hashomeryosh.org/home-en/ Data e regjistrimit: 18.6.2013 Numri i regjistrimit: 580575629	Hashomer Yosh është një OJQ izraelite që ofron mbështetje materiale dhe koordinon vullnetarët për punë bujqësore në fermat e bagëtieve, duke mbështetur të paktën 28 poste dhe vendbanime të dhunshme në Bregun Perëndimor duke rekrutuar vullnetarë të armatosur dhe duke siguruar roje të përfshira në sulme të dhunshme. Në veçanti, Hashomer Yosh po mbështet postet e themeluara nga individë të listuar nga Bashkimi Evropian: Neria Ben Pazi, themeluese e Postës së Fermës Rimoni; Zvi Bar Yosef, themelues i Fermës Zvi; Yinnon Levi, themelues i Fermës Mitari; dhe Moshe Sharvit, themelues i Postës së Fermës Tirza Valley / Ferma Moshe. Prandaj, Hashomer Yosh është përgjegjës për lehtësimin dhe inkurajimin e shkeljeve të drejtave të njeriut në Bregun Perëndimor, duke përfshirë abuzimet e të drejtës së pronës së palestinezëve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, si dhe të drejtën për integritet fizik dhe mendor, të cilat janë shqetësuese serioze në lidhje me objektivat e politikës së përhashkët të jashtme dhe të sigurisë të përcaktuara në Nenin 21 të Traktatit për Bashkimin Evropian.	28.5.2026'



2026/1176

28.5.2026

COUNCIL DECISION (CFSP) 2026/1176

of 28 May 2026

amending Decision (CFSP) 2020/1999 concerning restrictive measures against serious human rights violations and abuses

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 7 December 2020, the Council adopted Decision (CFSP) 2020/1999 ⁽¹⁾.
- (2) On 8 December 2020, by way of the Declaration by the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy, on behalf of the European Union, regarding the EU Global Human Rights Sanctions Regime, the Union and its Member States reaffirmed their strong commitment to the promotion and protection of human rights around the world. The EU Global Human Rights Sanctions Regime underscores the Union's determination to enhance its role in addressing serious human rights violations and abuses worldwide. Achieving the effective enjoyment of human rights by everyone is a strategic goal of the Union. Respect for human dignity, freedom, democracy, equality, the rule of law and human rights is a fundamental value of the Union and its common foreign and security policy.
- (3) In its conclusions of 19 March 2026, the European Council strongly condemned the continued and growing settler violence against Palestinian civilians and again reiterated its call on the Council to take work forward on further restrictive measures against extremist settlers and against entities and organisations that support them.
- (4) In that context, three persons and four entities should be included in the list of natural and legal persons, entities and bodies subject to restrictive measures in the Annex to Decision (CFSP) 2020/1999.
- (5) Decision (CFSP) 2020/1999 should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision (CFSP) 2020/1999 is amended in accordance with the Annex to this Decision.

*Article 2*This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 28 May 2026.

*For the Council**The President*

M. DAMIANOS

⁽¹⁾ Council Decision (CFSP) 2020/1999 of 7 December 2020 concerning restrictive measures against serious human rights violations and abuses (OJ L 410 I, 7.12.2020, p. 13, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dec/2020/1999/oj>).



EN

OJ L, 28.5.2026

ANNEX

The Annex to Decision (CFSP) 2020/1999 is amended as follows:

(1) the following entries are added to the list of natural and legal persons, entities and bodies under the heading 'A. Natural persons':

	Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
'136.	Daniella WEISS	דניאלה וייס (Hebrew spelling)	DOB: 30.8.1945 POB: Benet Brak, Mandatory Palestine (now Israel) Nationality: Israeli Gender: female	Daniella Weiss is the Director of the Nachala Movement ("Nachala"). Nachala has the aim of promoting Jewish settlements and illegal outposts in the West Bank. Through its activities, Nachala plays an instrumental role in facilitating and encouraging coercive acts that lead to the forced displacement of Palestinians and violate their right to property, their right to private and family life and their right to self-determination, as well as the right to life and to physical integrity. Nachala's outposts, such as Eyyatar, Maoz Esther, Oz Zion, Ramat Migron, Nachalat Zvi and Haeitam Farm, have been persistent sources of settler violence. Several Nachala outposts, including Yahish Zion, Maoz Esther, Oz Zion and Ramat Migron, were built on privately owned Palestinian land. All of Nachala's outposts obstruct access to Palestinian agricultural and grazing land. Furthermore, after 7 October 2023, Nachala has been at the forefront of efforts to resettle the Gaza Strip. In her capacity as Director, Daniella Weiss plans, directs and publicly supports the acts of Nachala. Therefore, she is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank and the Gaza Strip, including violations or abuses of the right of Palestinians to self-determination, their right to property, their right to private and family life, as well as the right to life and to physical integrity, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy set out in Article 21 of the Treaty on European Union. In her capacity as Director, Daniella Weiss is associated with Nachala.	28.5.2026



OJ L, 28.5.2026

EN

	Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
137.	Meir DEUTSCH	מאיר דויטש (Hebrew spelling)	Nationality: Israeli Gender: male	Meir Deutsch is the director general of Regavim, which is an Israeli NGO with an active pro-Israeli settler and settlement expansion agenda in the West Bank. Regavim institutes legal proceedings and lobbies for the demolition of Palestinian property with the aim of expanding the control of Israel to the whole West Bank. Through its activities, Regavim plays an instrumental role in facilitating and encouraging coercive acts that aim to destroy Palestinian property and demolish Palestinian homes, leading to forced displacement of Palestinians and violations of their right to property, their right to private and family life and their right to self-determination, as well as the right of everyone to the enjoyment of the highest attainable standard of physical and mental health. Regavim is responsible for multiple court proceedings, and lobbied for the demolition of a Palestinian primary school, funded by the European Union, at the Jabbet al Dhib village, near Bethlehem, in the West Bank in May 2023. Therefore, in his role as director general of Regavim, Meir Deutsch is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank, including abuses of the right to property, the right to private and family life and the right to education of Palestinians, as well as the right of everyone to the enjoyment of the highest attainable standard of physical and mental health, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy set out in Article 21 of the Treaty on European Union.	28.5.2026



EN

OJ L, 28.5.2026

	Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
138.	Avichai SUISSA	אִיכַי סויססא (Hebrew spelling)	DOB: 1.7.1986 Nationality: Israeli Gender: male ID: 038172441	Avichai Suissa is the CEO of Hashomer Yosh, which is an Israeli NGO that provides material support and coordinates volunteers for farm work on herding farms, supporting at least 28 violent outposts and settlements in the West Bank by recruiting armed volunteers and providing guards involved in violent attacks. In particular, Hashomer Yosh is supporting outposts founded by individuals listed by the European Union: Neria Ben Pazi, founder of the Rimoni Farm Outpost; Zvi Bar Yosef, founder of Zvi's Farm; Yinon Levi, founder of the Mitari Farm; and Moshe Sharvit, founder of the Tirza Valley Farm Outpost / Moshe's Farm. Therefore, Avichai Suissa is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank, including abuses of the right to property of Palestinians and their right to self-determination and the right to physical and mental integrity, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy set out in Article 21 of the Treaty on European Union.	28.5.2026



OJ L, 28.5.2026

EN

(2) the following entries are added to the list of natural and legal persons, entities and bodies under the heading 'B. Legal persons, entities and bodies':

Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
'38. Amana a.k.a. Amana – Cooperative Society for Community Settlement Ltd	אַמָּנָה (Hebrew spelling)	Address: Clermont-Ganneau St. 13, Jerusalem Website: https://amana.co.il/ Date of registration: 18.2.1979 Registration number: 570025742	Amana is the cooperative development company and settlement movement of the movement Gush Emunim. Since its creation, it has played a key role in initiating, financing and facilitating at least 30 violent outposts and settlements, including outposts founded by individuals listed by the European Union (Yinon Levi, founder of the Mitarim Farm Outpost; Moshe Sharvit, founder of the Tirza Valley Farm Outpost / Moshe's Farm; and Isaschar Manne, founder of the Manne Farm outpost) in the occupied West Bank. Along with settler violence emanating from them, including against human rights defenders, these outposts led to the widespread displacement of vulnerable Palestinian communities and dispossession of Palestinian properties. Amana's major involvement in these illegal violent outposts includes facilitating land acquisition, constructing and marketing houses, initiating and preparing settlements masterplans and funding infrastructure. On various occasions, the organisation and its management have clearly stated their objective of dispossessing Palestinian communities.	28.5.2026
			Therefore, Amana is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank, including abuses of the right to property of Palestinians and their right to self-determination, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy as set out in Article 21 of the Treaty on European Union.	



EN

OJ L, 28.5.2026

	Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
39.	Nachala Movement	נחל'ה (Hebrew spelling)	Address: West Bank, occupied Palestinian territories Website: https://www.nachalaisrael.org/	The Nachala Movement ("Nachala") has the aim of promoting Jewish settlements and illegal outposts in the West Bank. Through its activities, the movement plays an instrumental role in facilitating and encouraging coercive acts that lead to the forced displacement of Palestinians and violate their right to property, their right to private and family life and their right to self-determination, as well as the right to life and to physical integrity. Nachala's outposts, such as Eyvatar, Maoz Esther, Oz Zion, Ramat Migron, Nachalat Zvi and Haetiam Farm, have been persistent sources of settler violence. Several of these Nachala outposts, including Yahish Zion, Maoz Esther, Oz Zion and Ramat Migron, were built on privately owned Palestinian land. All of Nachala's outposts obstruct access to Palestinian agricultural and grazing land. After 7 October 2023, Nachala has furthermore been at the forefront of efforts to resettle the Gaza Strip. Therefore, Nachala is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank and the Gaza Strip, including abuses of the right of Palestinians to self-determination, their right to property, their right to private and family life, as well as the right to life and to physical health, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy set out in Article 21 of the Treaty on European Union.	28.5.2026



OJ L 28.5.2026

EN

	Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
40.	Regavim a.k.a. Regavim Movement	רגבים (Hebrew spelling)	Address: Rehovot, Mo'din, Jerusalem, Haifa, Maale Adumin, Ariel, Tel Aviv District, Efrat, Bersheeba Website: https://www.regavim.org/ Place of registration: Sha'ar Binyamin PO BOX 44439, Jerusalem, Israel, 9144302	Regavim is an Israeli NGO with an active pro-Israeli settler and settlement expansion agenda in the West Bank. Regavim institutes legal proceedings and lobbies for the demolition of Palestinian property with the aim of expanding the control of Israel to the whole West Bank. Through its activities Regavim plays an instrumental role in facilitating and encouraging coercive acts that aim to destroy Palestinian property and demolish Palestinian homes, leading to forced displacement of Palestinians. Regavim is responsible for multiple court proceedings, and lobbied, for the demolition of a Palestinian primary school, funded by the European Union, at the Jabbet al Dhīb village, near Bethlehem, in the West Bank in May 2023. Therefore, Regavim is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank, including violations of the right to property, the right to private and family life and their right to self-determination, and the right to education of Palestinians, as well as the right of everyone to the enjoyment of the highest attainable standard of physical and mental integrity, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy set out in Article 21 of the Treaty on European Union.	28.5.2026



EN

OJ L, 28.5.2026

Names (Transliteration into Latin script)	Names	Identifying information	Reasons for listing	Date of listing
41. Hashomer Yesh a.k.a. Guardians of Judea and Samaria, Guardians of Yehuda and the Shomron, Hashomer Judea and Samaria, Hashomer Yehudah, V'Shomron	השומר ישי (Hebrew spelling)	Address: Esh Kodesh 2, Shilo, 4483000 West Bank, occupied Palestinian territories Website: https://hashomeryesh.org/home-en/ Date of registration: 18.6.2013 Registration number: 580575629	Hashomer Yesh is an Israeli NGO that provides material support and coordinates volunteers for farm work on herding farms, supporting at least 28 violent outposts and settlements in the West Bank by recruiting armed volunteers and providing guards involved in violent attacks. In particular, Hashomer Yesh is supporting outposts founded by individuals listed by the European Union: Neria Ben Pazi, founder of the Rimoni Farm Outpost; Zvi Bar Yosef, founder of Zvi's Farm; Yinon Levi, founder of the Mitrim Farm; and Moshe Sharvit, founder of the Tirza Valley Farm Outpost / Moshe's Farm. Therefore, Hashomer Yesh is responsible for facilitating and encouraging human rights abuses in the West Bank, including abuses of the right to property of Palestinians and their right to self-determination, and the right to physical and mental integrity, which are of serious concern as regards the objectives of the common foreign and security policy set out in Article 21 of the Treaty on European Union.	28.5.2026

**VENDIM****Nr. 475, datë 26.6.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
ARKITEKTONIK I RRUGËVE “MYSLYM
GJOLEKA”, “AHMET LEPENICA”,
“HYSNI MUKA”, NË LAGJEN
“KUSHTRIMI”, BASHKIA VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti arkitektonik i rrugëve “Myslym Gjoleka”, “Ahmet Lepenica”, “Hysni Muka”, në lagjen “Kushtrimi”, Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 14 472 710 (katërmëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 14 472 710 (katërmëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim, për pasuritë “pronë private”, që miratohen me anë të këtij vendimi, do të verifikohen kufizimet hipotekare dhe likuidimi i pronarëve të shpronësuar do të bëhet pasi të vlerësohet dokumentacioni përkatës ligjor, lidhur me përmbushjen e detyrimeve financiare nga institucionet bankare.

10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

11. Bashkia Vlorë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI ARKITEKTONIK I RRUGËVE “MYSLYM GJOLEKA”, “AHMET LEPENICA”, “HYSNI MUKA”, NË LAGJEN “KUSHTRIMI”, BASHKIA VLORË

Pronari		Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)								Vlerësimet për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime		
Nr.	Emër/Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Truall						
										Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)				
1	Spiro Sejko Zeneli	8605	26/292	Truall	265.7	265.7	98.5	50	118	48.8	8300	405,040	405,040			
2	Petrit Qejvani	8605	26/308	Truall	277.9	277.9		63	59	38.5	8300	319,550	319,550			
3	Rudina Trifon Zotaj Artur Servet Zotaj	8605	26/323	Truall	134.8	134.8	55	54	181	14.5	8300	120,350	120,350			
4	Pushime Aliaj	8605	26/288	Truall	500	500	99	50	249	23.5	8300	195,050	195,050			
5	Lavdim Aliaj	8605	26/287	Apartament	282.6	282.6	46	50	248	19.7	8300	163,510	163,510			
6	Leli Jaupaj	8605	26/309	Truall	307.5	307.5		63	58	34	8300	282,200	282,200			
7	Merqes Alimucaj	8605	26/310	Truall	445.7	445.7		63	57	42	8300	348,600	348,600			
8	Jorgji Filip Skrami	8605	26/6	Truall	1085.09	1085.09		52	44	733	8300	6,083,900	6,083,900			
9	Enver Sejdi Veli	8605	10/224	Truall	404	404	119	34	128	43	8300	356,900	356,900			
10	Artan Shefqet Ademi	8605	26/224	Truall	433	433	127	42	23	36	8300	298,800	298,800			
11	Virjon Nexhat Lamaj	8605	26/226	Truall	498	498	132	42	25	16.7	8300	138,610	138,610			
12	Hamdi Hakim Osmeni	8605	26/128	Truall	300	300	145.7	35	100	5.8	8300	48,140	48,140			
13	Gani Mane Mema	8605	26/274	Truall	393	393	137	46	225	5.8	8300	48,140	48,140			
14	Qerim Nubi Ajazaj	8605	26/290	Truall	363	363		49	209	3	8300	24,900	24,900			
15	Sotir Seit Vallaj	8605	22/381	Truall	309.1	309.1	103.7	411	641	6.9	8300	57,270	57,270			
16	Petrit Osmën Hoxhaj	8605	22/566	Truall	332	332	110	64	57	12.5	8300	103,750	103,750			
17	Kujtim Hasimaj	8605	21/227	Truall	408	408		57	90	14	8300	116,200	116,200			
18	Selime Qeman Bitaj Loren Resmi Bitaj Klarida Resmi Runaj Ledjon Resmi Bitaj	8605	21/215	Truall	484	484	109	49	62	53	8300	439,900	439,900			
19	Luiza Xhipe Sinani	8605	21/219	Truall	452	452	101	50	25	23.5	8300	195,050	195,050			
20	Moisi Sako Lazaj	8605	21/195	Truall	280	280	111	46	123	12	8300	99,600	99,600			
21	Bedri Hate Shameti	8605	21/96	Truall	475	475	61	29	78	12	8300	99,600	99,600			
22	Nizajete Turku Ulesi Mezini Fatmir Mezini Vasfi Mezini Kastriot Mezini Habibe Mersinaj Gezim Mersinaj Mersin Mersinaj Agim Mersinaj Shafie Mersinaj Galip Mersinaj Sanie Mersinaj Iqmet Mersinaj Maksim Mersinaj Hektor Mersinaj Fitim Mersinaj Fiqeret Mersinaj Nesie Mersinaj	8605	21/155	Truall	2779	2779		36	9	100	8300	830,000	830,000			
23	Besnik Novrus Balli	8605	11/133	Truall	1120	1120		33	59	98.5	8300	817,550	817,550			
24	Articel Piro Çelohoxhaj Aloderim Piro Çelohoxhaj	8605	11/193	Truall	278	278	139	48	156	55.5	8300	460,650	460,650			
25	Zaim Muharrem Kokalla	8605	11/120	Truall	300	300	86	30	74	15	8300	124,500	124,500			
26	Robert Petro Tika	8605	11/202	Truall	350	350	81	50	88	53	8300	439,900	439,900			
27	Gezim Shago Cobaj	8605	11/188	Truall	340	340	129	45	60	49	8300	406,700	406,700			
28	Bedri Elmas Caushi	8605	21/189	Truall	258	258	105	44	128	5.2	8300	43,160	43,160			
29	Besjan Skender Lelaj	8605	22/421	Truall	229	229	95	44	45	13.8	8300	114,540	114,540			
30	Avni Mersin Myzeqari	8605	26/147	Truall	379	379	110.7	35	179	4.6	8300	38,180	38,180			
31	Vangjel Koli Mino	8605	26/332	Truall	442	442	120	60	124	5	8300	41,500	41,500			
32	Feridon Shaban Shparthi	8605	26/218	Truall	479	479	134	42	9	9.5	8300	78,850	78,850			
33	Ylli Haki Ramadani	8605	26/138	Truall	279.9	279.9	102	34	131	32	8300	265,600	265,600			
34	Ylli Esat Xhelaj	8605	26/213	Truall	277	277	101	411	881	15	8300	124,500	124,500			
35	Saliko Brahimi	8605	26/195	Truall	500	500	146	38	168	22.4	8300	185,920	185,920			
36	Tasim Serjan Myftari	8605	26/328	Truall	376	376	62	58	165	13.7	8300	113,710	113,710			
37	Albert Miti Kungulli	8605	26/193	Truall	371.5	371.5	110	38	43	8	8300	66,400	66,400			
38	Luljeta Nun Kapaj	8605	26/231	Truall	373	373	102	42	182	14.2	8300	117,860	117,860			
39	Ilir Zihni Resulaj Sokol Zihni Resulaj	8605	26/229	Truall	339	339	153	42	144	15.7	8300	130,310	130,310			
40	Nuri Ismet Xhakaj	8605	26/240	Apartament	398.3	398.3	113	47	128	15.4	8300	127,820	127,820			
VLERA TOTALE													14,472,710			



VENDIM
Nr. 477, datë 26.6.2026

ndryshuar, me propozimin e ministrit të
Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË, DHE QEVERISË SË
KONFEDERATËS ZVICERANE, TË
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM, QË VEPRON
NËPËRMJET AMBASADËS SË ZVICRËS
NË SHQIPËRI, PËR PROJEKTIN E
VLERËSIMIT TË DËMEVE NË
NDËRTESA, NJË FAZË E VETME,
2025–2029**

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për projektin e vlerësimit të dëmeve në ndërtesa, një fazë e vetme, 2025 - 2029, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të

MARRËVESHJE

NDËRMJET

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

DHE

**QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE
TË PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM
QË VEPRON NËPËRMJET
AMBASADËS SË ZVICRËS NË SHQIPËRI**

PËR

**PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË DËMEVE NË NDËRTESA
NJË FAZË E VETME, 2025-2029**



Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy Vendeve;

Në përputhje me dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me Ligjin Nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

Në kuadër të respektimit të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut, siç ato përcaktohen veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut që frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dy Palëve dhe përbën element thelbësor që pajtohet me objektivat e kësaj Marrëveshjeje,

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim e referuar si "MIE" dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (në vijim e referuar si "SDC") kanë rënë dakord lidhur me termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë:

Neni 1 **Kushtet e Përgjithshme dhe Përkufizimet**

Kudo që janë përdorur në këtë Marrëveshje, termat në vijim kanë kuptimet e më poshtme përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

- a) "Palët Kontraktuese" nënkupton Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Konfederatës Zvicerane.
- b) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- c) "MIE" është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- d) "Konfederata Zvicerane" përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme.
- e) "SDC" nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga Ambasada e Zvicrës.
- f) "Projekti" nënkupton "Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa, Një Fazë e Vetme" të financuar nga SDC-ja.
- g) "MP" nënkupton Marrëveshjen e Projektit për Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa.
- h) "VDN" nënkupton Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa.
- i) "Partner Zbatues" nënkupton institucionin zbatues publik të Institutit të Ndërtimit dhe Partner Bashkëpunues të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- j) "NJZP" nënkupton Njësinë e Zbatimit të Projektit që përbëhet nga një menaxher projekti ndërkombëtar, një këshilltar teknik dhe një ekspert për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa nga njësi e Ndihmës Humanitare Zvicerane, si dhe një zëvendës menaxher vendas projekti, të vendosur në Institutin e Ndërtimit, me qëllim lehtësimin e zbatimit të aspekteve operacionale, teknike dhe financiare të Projektit.



- k) "Kontribut" nënkupton kontributin e parimbursueshëm financiar që SDC-ja ofron në kuadër kësaj MP-je;

Neni 2

Përgjegjësia e Zbatimit

1. MIE është agjencia homologe e Projektit.
2. SDC-ja i siguron mbështetje teknike Partnerit Zbatues dhe Bashkëpunues me qëllim zbatimin e katër komponentëve të Projektit, nëpërmjet NJZP-së.
3. Ambasada e Zvicrës në Shqipëri harton një kontratë kontributi me Institutin e Ndërtimit për të udhëhequr dhe zbatuar katër shtyllat e Projektit: (i) Forma dhe manuali i VDN-së (rezultati 1); (ii) Trajnimi dhe certifikimi për VDN-në (rezultati 2); (iii) Procedurat Standarde Operacionale (PSV) (rezultati 1); dhe (iv) Ndërgjegjësimi publik (rezultati 3). Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile mbështet zbatimin e shtyllës tre dhe katër të Projektit.
4. Ambasada e Zvicrës në Shqipëri mbikëqyr zbatimin e Projektit.

Neni 3

Qëllimet dhe Objektivat

1. Qëllimi i përgjithshëm i këtij Projekti është që institucionet shqiptare të menaxhimit të riskut, të pajisura me kapacitete teknike dhe njohuri moderne, sigurojnë shërbime të qëndrueshme dhe të efektshme të vlerësimit të dëmeve në ndërtesa pas tërmeteve, duke rezultuar në kushte më të sigurta jetese dhe mjedis biznesi me aftësi më të mira ripërtëritëse.

2. Objektivat kryesore të Projektit janë:

- a) Kuadri ligjor dhe i politikave për vlerësimin e dëmeve të ndërtesave pas fatkeqësive përmirësohet dhe harmonizohet me standardet ndërkombëtare.
- b) Instituti i Ndërtimit dhe bashkitë kanë kapacitete të mjaftueshme institucionale dhe teknike për kryerjen e vlerësimit të dëmeve në ndërtesa me transparencë më të madhe për publikun.
- c) Ndërgjegjësimi publik lidhur me risqet sizmike, sigurinë nga tërmetet, procedurat dhe standardet pas fatkeqësisë, forcohet.

Për përmbushjen e këtyre objektivave, Projekti bashkëpunon me institucionet e mëposhtme:

- a) MIE-n dhe Ministrinë e Mbrojtjes.
- b) Institutin e Ndërtimit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, prefekturat dhe sektorët/drejtoritë e emergjencave civile në bashki, të cilat janë pjesë e sistemit të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë.
- c) Institucionet e arsimit të lartë, median, shoqërinë civile dhe sektorin privat.
- d) Programe dhe projekte të tjera në fushat përkatëse për të garantuar sinerghi dhe qasje të bashkërenduara.

Linjat kryesore të ndërhyrjeve dhe rezultatet e parashikuara pasqyrohen në Përmbledhjen



e Projektit sipas Shtojcës 1.

Neni 4 **Objekti i Marrëveshjes**

Marrëveshja mbulon veprimtaritë e përcaktuara në Përmbledhjen e Projektit, e cila i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje (Shtojca 1). Përmbledhja e Projektit është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 **Përgjegjësitë e SDC-së**

- a) Kontributi i SDC-së është në formën e shërbimeve të ofruara për partnerin zbatues të Institutit të Ndërtimit, siç përcaktohet në Shtojcën 1: Përmbledhja e Projektit.
- b) Kontributi i SDC-së është në një vlerë maksimale prej 1.811.400 (një milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind) CHF (franga zvicerane), siç pasqyrohet në Shtojcën 2: Buxheti.
- c) Kontributi i SDC-së nuk mund të jepet për asnjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit, e cila do të mbetet në fund të projektit, i kthehet SDC-së.

Neni 6 **Përgjegjësitë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

- a) mbështet dhe lehtëson lidhjen dhe bashkëpunimin me ministri dhe institucione të tjera;
- b) mbështet shqyrtimin dhe miratimin e akteve nënligjore për protokollin e ri të Vlerësimit të Dëmeve në Ndërtesa;

Neni 7 **Menaxhimi i Projektit**

Projekti është sipërmarrje e përbashkët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe SDC-së nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Nga ana zvicerane:

- SDC-ja siguron ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas si pjesë e NJZP-së, me qëllim mbështetjen e zbatimit të Projektit.
- Ambasada e Zvicrës në Shqipëri është bashkëpërgjegjëse për bashkëdrejtimin e mbledhjeve të Komitetit Drejtues të Projektit.

Nga ana shqiptare:

- MIE është bashkëpërgjegjëse për bashkëdrejtimin e mbledhjeve të Komitetit Drejtues të Projektit.
- MIE ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lehtësimin e zbatimit të veprimtarive



të Projektit, për të cilat është rënë dakord.

- MIE siguron kapacitete për të ndihmuar Partnerin Zbatues në pjesë të ndryshme të Projektit;
- MIE garanton akses në informacionin përkatës, duke përfshirë të dhënat statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e Projektit.

Çdo përdorim tjetër duhet t'i nënshtrohet pëlqimit paraparak me shkrim të MIE-s.

Neni 8 **Mbikëqyrja dhe Koordinimi**

1. Me qëllim garantimin e mbikëqyrjes dhe bashkërendimit të përgjithshëm të projektit, si dhe me qëllim trajtimin e çështjeve të politikave, ngrihet Komiteti Drejtues, i cili mbledhet dy herë në vit. Komiteti Drejtues arrin kuorumin vetëm kur përfaqësuesit e të dy Palëve Kontraktuese janë të pranishëm dhe vendimet merren me konsensus.
2. Komiteti Drejtues mbledhet çdo gjashtë muaj. Ai përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm, me të drejtë vendimmarrjeje:
 - a) 1 përfaqësues i MIE-s (bashkëdrejtues i Komitetit Drejtues).
 - b) 1 përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes.
 - c) 1 përfaqësues i Ambasadës së Zvicrës (bashkëdrejtues i Komitetit Drejtues).
 - d) 1 përfaqësues nga Shoqata e Qeverisjes Vendore.
 - e) 1 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

Statusi i vëzhguesit në Komitetin Drejtues iu jepet anëtarëve të mëposhtëm:

- a) Drejtori i Institutit të Ndërtimit dhe Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- b) 1 përfaqësues të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe agjencive të tjera përkatëse shtetërore.
- c) 1 përfaqësues të Universitetit nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit.
- d) 1 përfaqësues nga Shoqata e Sektorit të Ndërtimit.
- e) 1 përfaqësues i medias.
- f) Përfaqësuesve të bashkive dhe qarqeve të interesuara.
- g) Përfaqësuesve të donatorëve të tjerë të interesuar në këtë temë.

Vëzhguesit nuk kanë të drejtën e marrjes së vendimeve.

Sipas nevojës dhe temës së diskutimit, grupe të tjera interesi mund të ftohen të marrin pjesë si vëzhgues.

Sekretariati i Komitetit Drejtues sigurohet nga NJZP-ja. Menaxheri Ndërkombëtar i Projektit dhe Zëvendës Menaxheri vendas i Projektit marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vendimmarrjeje.



3. Komiteti Drejtues do të realizojë detyrat e mëposhtme:

- a) Siguron drejtim, mbikëqyrje dhe mbështetje strategjike për zbatimin e suksesshëm të veprimtarive të Projektit dhe arritjen e rezultateve të pritshme, si dhe mundëson transparencën dhe nxit pronësinë e Projektit ndër grupet kryesore të interesit.
- b) Miraton planin vjetor të operacioneve dhe raportet vjetore të progresit.
- c) Zgjidh mosmarrëveshjet e mundshme, të cilat mund të rezultojnë gjatë zbatimit të Projektit.

Me kërkesë të një prej anëtarëve të Komitetit Drejtues me të drejtë vote, mund të shpallen mbledhje jashtë radhe të Komitetit. Mbledhjet kryesohen nga bashkëkryetarët e Komitetit Drejtues.

Neni 9 Raportimi dhe Informacioni

Raportet e progresit dhe financiare përgatiten nga NJZP-ja dhe Partneri Zbatues çdo 6 muaj.

Palët Kontraktuese informojnë menjëherë njëra-tjetrën, në masën që është praktikisht e arsyeshme, si dhe këshillohen me njëra-tjetrën lidhur me çdo rast që ndikon ose rrezikon të ndikojë në zbatimin e suksesshëm të Projektit.

Neni 10 Monitorimi dhe vlerësimi

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri mbikëqyr zbatimin e Projektit.

Gjatë vitit të dytë të zbatimit të Projektit do të organizohet një Shqyrtim i Ndërmjetëm i jashtëm. Një vlerësim i jashtëm përfundimtar i Projektit është planifikuar të zhvillohet në vitin 2029.

Neni 11 Prokurimi

Partneri Zbatues është përgjegjës për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin e projektit, sipas parimeve të konkurrencës së ndershme (të lirë dhe të barabartë) për të gjithë ofertuesit e mundshëm, me qëllim përdorimin efikas të fondeve të projektit.

Partneri Zbatues zbaton legjislacionin shqiptar për prokurimet.

Neni 12 Mallrat

- a) Gjatë kohëzgjatjes së Projektit, mallrat e siguruar me fondet e SDC-së që përdoren për Projektin, vihen në dispozicion të pakufizuar të tij dhe nuk do të devijohen nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.
- b) Nëse Projekti duhet të ndërpritet për çfarëdolloj arsyeje, përdorimi i mallrave të siguruar me kontribut zviceran vendoset me shkrim nga Palët. Në këtë rast, SDC-ja nuk merr asnjë përgjegjësi të çfarëdo lloji lidhur me mallrat e lartpërmendura.



- c) Në fund të Projektit, SDC-ja vendos lidhur me pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar me fondet e Projektit.
- d) Mallrat e prokuruar nga Projekti për institucionet partnere, i dorëzohen dhe merren në dorëzim nga autoritetet kompetente përkatëse me miratimin e SDC-së.

Neni 13

Ndërprerja e Marrëveshjes

- a) Secila Palë ka të drejtë ta ndërpresë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim gjashtë muaj përpara ndërprerjes në fjalë.
- b) Nëse njëra nga Palët çmon se synimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të përmbushen më, ose që Pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala ka të drejtë ta pezullojë ose ndërpresë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim tre muaj para. Pavarësisht nga sa më sipër, secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm, në rast të ndonjë shkeljeje thelbësore të Marrëveshjes. Shkelja thelbësore nënkupton shkelje të rëndë të një prej objektivave thelbësore të kësaj Marrëveshjeje.
- c) Në rast se ngjarjet e forcës madhore (fatkeqësi natyrore etj) pengojnë zbatimin e Marrëveshjes, secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje që nga momenti kur bëhet i pamundur zbatimi i saj.
- d) Në rast të një ndërprerjeje të parakohshme të kësaj Marrëveshjeje ose në fund të Projektit, çdo fond i pashpenzuar i siguruar në kuadër të Projektit, i kthehet SDC-së.

Neni 14

Ndryshimet dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo ndryshim i Marrëveshjes do të jetë i vlefshëm nëse bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet Palëve.

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet negociatave diplomatike midis Palëve.

Neni 15

Dispozita të Përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Palët nuk propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përfitime të çfarëdolloj natyre. Palët nuk pranojnë asnjë propozim të tillë. Çdo sjellje korrupsioni ose e paligjshme përbën shkelje thelbësore të kësaj Marrëveshjeje dhe shkak për ndërprerjen e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Shtojcat

Përmbledhja e Projektit (Shtojca 1), Buxheti (Shtojca 2) dhe Strategjia e Zbatimit të Projektit për Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa (Shtojca 3) janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.



Neni 17
Kohëzgjatja dhe Hyrja në Fuqi

Marrëveshja në fjalë është e vlefshme nga data e hyrjes në fuqi deri më 31.12.2029.

Ajo hyn në fuqi në datën e njoftimit nga pala shqiptare lidhur me përfundimin e procedurës së brendshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjeje lidhur me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes së Projektit, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Palët konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të përpiluar në Tiranë më 19/05/2026

**PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

ENEA KARAKAÇI

**MINISTËR
MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË**

**PËR KONFEDERATËN
ZVICERANE**

RUTH HUBER

**AMBASADORE
AMBASADA E ZVICRËS NË
SHQIPËRI**

Lexuar dhe Rënë Dakord

**Persida Shkrepa
Drejtor i Përgjithshëm
Instituti i Ndërtimit**

Lexuar dhe Rënë Dakord

**Maki Çako
Director General
National Civil Protection Agency**



Shtojca 1: Përmbledhje e Projektit për Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa

Një Fazë e Vetme: 2025 –2029

Buxheti: 1.811.400,-- CHF

1. Orientimi Strategjik

Konteksti: Shqipëria ka riskun më të lartë të vlerësuar nga fatkeqësitë natyrore në Evropë për shkak të ekspozimit ndaj rreziqeve natyrore dhe kapaciteteve të kufizuara përballuese¹. Risqet përfshijnë tërmetet, përmbytjet, zjarret pyjore dhe rrëshqitjet e dherave. Cënueshmëria e Shqipërisë ndaj fatkeqësive natyrore u vu re gjatë tërmetit të 26 nëntorit 2019 që shkaktoi 51 vdekje, 1.700 ndërtesa të shembura, 3.600 ndërtesa të dëmtuara rëndë dhe 200.000 individë të prekur. Dëmet dhe humbjet e kombinuara vlerësohen në rreth 7,5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2018 ose 985 milionë Euro.²

Qeveria e Shqipërisë (QSH) është e angazhuar që të përmirësojë kuadrin politik dhe institucional për Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa (VDN). Kjo pasqyrohet në përmirësimin e kuadrit ligjor me miratimin e një udhëzimi për VDN-në në dhjetor të vitit 2019. Projekt aktet nënligjore për përcaktimin e Kodit Evropian të ndërtesave si të detyrueshëm, janë gati për procesin e miratimit. Projektligji për vënien në funksion të sigurimit të detyrueshëm për katastrofat për pronarët e banesave dhe bizneseve është gjithashtu në prag miratimi. Tashmë Shqipëria është anëtare e mekanizmit të BE-së për Mbrojtjen Civile.

Pavarësisht përmirësimit të kuadrit të politikave, sistemi i VDN-së përballet me *sfidat* e mëposhtme: (1) Kuadri ligjor nuk përmbush standardet ndërkombëtare. (2) Institucionet e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror dhe vendor kanë kapacitete dhe burime të kufizuara. (3) Mungojnë trajnimet e certifikuara për inxhinierët e ndërtimit të bashkive. (4) Ofrimi i shërbimeve publike ka cilësi të ulët dhe nuk i komunikohet në mënyrë të mjaftueshme publikut.

Në vazhdim të tërmetit, donatorët ndërkombëtarë angazhuan 1,15 miliardë Euro në mbështetje të rimëkëmbjes, duke përfshirë një grant me vlerë 9 milionë Euro nga Zvicra.

Rezultatet e arritura: Përgjigja e shpejtë e SDC-së e ofruar përmes Ndhmës Humanitare Zvicerane (NHZ), arriti rezultatet e mëposhtme: (1) 1.4 milion% CHF të angazhimit zviceran u përdorën si kontribut për grante për rehabilitimin e ndërtesave të dëmtuara për 565 familje në bashkitë Shijak dhe Kurbin. (2) U ofrua ndihmë emergjence për 5.000 individë në 11 bashki të prekura. (3) NHZ-ja ndërmori 3 misione vijuese për të përcaktuar mbështetjen afatgjatë të SDC-së për procesin e rindërtimit në Shqipëri. Misionet konfirmuan se VDN-ja pas fatkeqësisë, e ndërmarrë nga autoritetet publike, ishte e një cilësie të ulët dhe nuk iu komunikua në mënyrë të mjaftueshme popullsisë.

Rëndësia: Zvicra mund të luajë tre role plotësuese lidhur me VDN-në që është sektor i ngushtë i reformës me rëndësi jashtëzakonisht të madhe: si donator, si advokues dhe si grup interesi. Kombinimi i këtyre tre roleve i lejon Zvicrës që të shfrytëzojë rolin e vet plotësues dhe të forcojë pozicionin si partner i besueshëm për përmirësimin e efektshmërisë dhe efikasitetit të ndërhyrjes. Ajo sjell ekspertizë të lartë teknike dhe përvojë të pasur me praktika novatore që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Projekti mëkon sinergjitë me projektet aktuale të mbështetura nga Zvicra në fushën e qeverisjes demokratike dhe fuqizimin e bashkive, duke përfshirë transferimin e njohurive në shkallë të gjerë përmes trajnimeve gjatë detyrës. Modaliteti i ndihmës integron qasjen nga ndihma gjatë emergjencës në zhvillim afatmesëm dhe më afatgjatë, çka përbën mundësi unike për zbatimin e një projekti të ndërlidhur në harmoni me procesin e "përshtatshmërisë për qëllimin" të SDC-së.

Koherenca me ndihmën zvicerane: Projekti është në përputhje të plotë me qëllimet e

¹ Raporti i Riskut Botëror 2021. https://weitriskobericht.de/wp-content/uploads/2021/09/WorldRiskReport_2021_Online.pdf

² Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë, 2020. <https://www.undp.org/albania/publications/albania-post-disaster-needs-assessment>



politikave të zhvillimit të Shqipërisë, të cilat pasqyrohen në Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) 2023-30. Ai jep kontribut për progresin drejt arritjes së nënobjektivit 6 të Strategjisë Zvicerane për Bashkëpunim Ndërkombëtar 2021-24 dhe një prej katër temave me përparësi të NHZ-së. Synimi i tij është në koherencë me Programin e Bashkëpunimit të Zvicrës me Shqipërinë 2022-25 dhe korrespondon me Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) 11 "Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme". Projekti është në përputhje me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF) 2015-30. Elementët plotësues do të nxiten më tej me projektet e Bashkive të Forta, Shërbimet Klimatike ALBA Adapt për një Shqipëri me Aftësi Ripërtëritëse, Klima dhe Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri, dhe Financimi dhe Sigurimet për Riskun nga Fatkeqësitë, të financuara nga Zvicra.

Grupet e synuara: *Përfituesit e drejtpërdrejtë* janë: (i) Instituti i Ndërtimit (IN), Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), dhe strukturat e sektorëve dhe drejtorive të emergjencave civile në nivel vendor të cilat janë pjesë e sistemit të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë. Projekti do të vendoset në IN. (ii) Inxhinierët e ndërtimit të bashkive, të cilët janë përgjegjës për kryerjen e VDN-së, si dhe personeli i organeve publike të mbrojtjes civile në nivel kombëtar dhe vendor të ngarkuar me detyra të mbrojtjes civile. *Përfituesit fundorë* janë: Qytetarët dhe shoqëria civile, të cilët janë ndikuar nga tërmetet, duke përfshirë grupet e cënueshme dhe të përjashtuara në shoqëri që shpesh ndikohen disproporcionalisht nga rreziqet natyrore.

Afati dhe financimi: Bazuar në vlerësimet e mëparshme, afati për këtë fazë të vetme projekti është periudha 2025 - 2029. Për arritjen e rezultateve konkrete nuk është e nevojshme të organizohet angazhim afatgjatë. Gjithashtu, kjo nuk është fushë me përparësi në Programin e Bashkëpunimit. Fondet totale që do të mobilizohen nga SDC-ja dhe NHZ-ja arrijnë në vlerën 1.811.400 CHF.

Mësimet e nxjerra janë: (1) Në kuadër të axhendës së reformave në Shqipëri lidhur me anëtarësimin në BE, përmirësimi i kuadrit të politikave për VDN-në në përputhje me standardet ndërkombëtare, vijon të jetë përparësi. (2) Kalimi drejt shërbimeve publike cilësore dhe transparente për VDN-në është i nevojshëm, me qëllim mundësimin e kushteve më të sigurta të jetesës dhe një mjedisi biznesi me më shumë aftësi ripërtëritëse. (3) Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i publikut është ende i nevojshëm, sepse qytetarët nuk kanë ende dijeni të mjaftueshme për risqet sizmike dhe mekanizmat pas fatkeqësisë.

Qëndrueshmëria dhe vizioni pas përfundimit të projektit: Në fund të fazës së vetme të tij, projekti ka advokuar që QSH-ja të vendosë në dispozicion burimet e nevojshme financiare për mbështetjen e shërbimeve të qëndrueshme të VDN-së dhe fushatat e ndërgjegjësimit publik. Sistemi i ngritjes së kapaciteteve për shërbimet e VDN-së është funksional kur përfshihet në sektorin publik. Ai ka ndihmuar në konsolidimin e institucioneve të efektshme të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë të (1) IN-it dhe bashkive, të cilat do të vijnë të ofrojnë shërbime publike të qëndrueshme dhe transparente të VDN-së, bazuar në kuadrin e përmirësuar ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare; (2) dhe AKMC-së që do të vijnë të organizojë fushata të ndërgjegjësimit publik në mënyrë të qëndrueshme.

2. Vlerësimi i palëve të interesit

Projekti ka zhvilluar një perceptim të thellë të nevojave dhe interesave të palëve kyçe të interesit të sektorit publik, shoqërisë civile, sektorit privat dhe donatorëve. Institucionet e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar dhe vendor, duke përfshirë Institutin e Ndërtimit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe bashkitë, e kanë një vizion për arritjen e standardeve ndërkombëtare dhe janë të interesuara të përmirësojnë besimin që publiku ka për shërbimet e tyre të VDN-së.

Instituti i Ndërtimit funksionon si institucion publik në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Ai do të jetë partneri kryesor i projektit për Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri dhe do të nënshkruhet një marrëveshje projekti me MIE-n. IN ka rreth 60 punonjës. Institucioni është i ngarkuar me ofrimin e ekspertizës teknike për kryerjen e VDN-së. Ai ka një grup profesionistësh të afië me ekspertizë dhe përvojë në



ndërtim dhe inxhinieri. IN do të mirëpresë Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP) si dhe do të ofrojë sallat e trajnimit. Ai do të rekrutojë një Financier të ri në kuadër të kontributit të vet për zbatimin e tre komponentëve të projektit.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është institucioni kryesues në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) të ngarkuar me menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, mbrojtjen civile dhe zbatimin e projekteve strategjike të SKZRF-së. Ajo luan rol kyç në hartimin e Procedurave Standarde Operacionale (PSV) për emergjencat civile dhe bashkërendon përgjigjen kombëtare ndaj fatkeqësive gjatë situatave të emergjencës. Ajo ka 120 punonjës gjithsej. AKMC-ja ka bashkëpunim shumë të mirë me IN-in, prefekturat dhe bashkitë.

Bashkive u është besuar kryerja e vlerësimit të risqeve vendore, përgatitja e planeve vendore të emergjencave civile dhe bashkërendimi i përgjigjes ndaj fatkeqësive në nivel vendor. Vendi ka gjithsej 61 bashki të organizuara në 12 qarqe. Bashkitë janë partneri kryesor për fushatat e ndërgjegjësimit publik.

Shoqëria Civile, Universiteti, individët dhe sektori privat janë të interesuar të përfitojnë nga shërbimet cilësore të VDN-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, mund të ketë rezistencë nga pronarët e banesave ose bizneseve, nëse procedurat e reja të VDN-së sjellin standarde më rigorozë sigurie dhe nëse ata duhet të largohen nga banesat pa kompensim të përshtatshëm ose zgjidhje alternative.

Donatorët: Ambasada e Zvicrës në Tiranë do të bashkërendohet rregullisht me BB-ne, PNUD-in, GIZ-in, Bashkëpunimin Italian dhe JICA-n, në kuadër të Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike.

3. Objektivat

Projekti do të punojë me IN-in për miratimin dhe zbatimin e *kuadrit ligjor* për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa në raste tërmetesh dhe mundësisht përmbytjesh, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai do të *forcojë aftësitë institucionale të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë* dhe sistemin në nivel kombëtar dhe bashkiak. Më specifikisht, projekti do të mbështesë së pari IN-in me përgatitjen e materialeve të trajnimit për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa nga tërmete dhe mundësisht përmbytjet, dhe së dyti me krijimin e një grupi prej 10 trajnuesish të cilët do të ofrojnë trajnime të certifikuar për 207 inxhinierët e ndërtimit të bashkive, deri në fund të vitit 2029. Projekti do të përmirësojë aftësitë ripërtëritëse të IN-it dhe 61 bashkive për t'u përballur më mirë me tërmetet dhe mundësisht përmbytjet përmes ofrimit të shërbimeve transparente të vlerësimit të dëmeve në ndërtesa për popullsinë e prekur. Projekti do të vijojë bashkëpunimin me AKMC-në dhe bashkitë për rritjen e ndërgjegjësimit publik për përgatitjen për tërmetet dhe përmbytjet.

Qëllimi i përgjithshëm: Institucionet shqiptare të menaxhimit të riskut, të pajisura me kapacitete teknike dhe njohuri moderne, ofrojnë shërbime të qëndrueshme dhe të efektshme të vlerësimit të dëmeve në ndërtesa pas tërmeteve, duke rezultuar në kushte më të sigurt jetese dhe mjedis biznesi me aftësi më të mira ripërtëritëse.

- **Rezultati 1:** Kuadri ligjor dhe i politikave për vlerësimin e dëmeve të ndërtesave pas fatkeqësive, përmirësohet dhe harmonizohet me standardet ndërkombëtare.
- **Rezultati 2:** Instituti i Ndërtimit dhe bashkitë kanë kapacitete të mjaftueshme institucionale dhe teknike për kryerjen e vlerësimit të dëmeve në ndërtesa, me transparencë më të madhe për publikun.
- **Rezultati 3:** Forcohet ndërgjegjësimi publik lidhur me risqet sizmike, sigurinë nga tërmetet, procedurat dhe standardet pas fatkeqësisë.

Projekti bazohet në **Teorinë e ndryshimit:**

Nëse kuadri shqiptar i politikave, ligjor dhe institucional për vlerësimin e dëmeve në ndërtesa pas fatkeqësive përforcohet në përputhje me standardet ndërkombëtare,



Nëse ofrimi i shërbimit publik të vlerësimit të dëmeve në ndërtesa është i qëndrueshëm dhe transparent, dhe nëse ndërgjegjësimi publik për risqet nga tërmetet dhe sigurinë, si dhe mekanizmat pas fatkeqësive rritet,

atëherë kushtet e jetesës do të jenë më të sigurta dhe mjedisi i biznesit do të ketë aftësi më të mëdha ripërtëritëse,

sepse institucionet e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë do të jenë të përgatitura më mirë për vlerësimin e saktë të ndikimit të tërmetit në ndërtesa dhe do të përgjigjen në mënyrë më të efektshme duke caktuar ndihmë të bashkërenduar në komunitetet e ndikuara.

Tema të ndërthurura: Projekti do të integrojë *çështjet gjinore dhe të përfshirjes sociale* në ndërhyrjet e veta. Ai do të promovojë barazinë ekuilibrit gjinor duke siguruar që 20% e të gjithë inxhinierëve të ndërtimit të trajnuar në IN dhe në bashkitë përkatëse të jenë gra. Projekti do të përçojë mesazhe me ndjeshmëri gjinore dhe për përfshirjen sociale gjatë fushatave të ndërgjegjësimit të publikut duke u përqendruar në mënyrë të përkushtuar diversitetit dhe përfshirjes. Projekti përfshin *qeverisjen* në objektivat e veta, me synim përf forcimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për VDN në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ofrimin e shërbimeve publike transparente. Do të vendosen lidhje të forta me Projektin Bashki të Forta të SDC-së, duke rezultuar në integrimin e efektshëm të çështjeve të qeverisjes në nivel bashkie.

4. Strategjia e Ndërhyrjes

Projekti do të zbatohet nga SDC-ja në formatin e Veprimit të Drejtpërdrejtë (VD), të zbatuar kryesisht nga ekspertët e njësive të NHZ-së dhe lehtësuar nga NJZP përgjegjëse për aspektet operacionale, financiare dhe teknike. NJZP-ja përbëhet nga një menaxher projekti ndërkombëtar nga NHZ-ja, një zëvendës menaxher projekti vendas, një mbështetës teknik nga NHZ-ja dhe një ekspert ndihmës nga NHZ-ja. NJZP-ja bashkërendon ngushtë punën me institucionet publike dhe drejton zbatimin e projektit. NJZP-ja punon në ambientet e IN-it. Kjo do të përforcojë përgjegjësinë e IN-së për shërbimet e VDN.

Projekti do të mbikëqyret nga Ambasada e Zvicrës në Tiranë, që do të hartojë një kontratë kontributi me IN-in. Projekti do të zbatohet **katër komponentë** me anë të një qasjeje të ndërlidhur për arritjen e objektivit të vet për ngritjen e një sistemi të fuqishëm të VDN në Shqipëri. IN do të mbështesë zbatimin e *tre komponentëve* për: (1) përmirësimin e mjedisit mundësues; (2) forcimin institucional; (3) dhe ngritjen e kapaciteteve. AKMC-ja do të mbështesë zbatimin për *dy komponentëve* për: (4) Ndërgjegjësimin publik lidhur me përgatitjen për fatkeqësi dhe Hartimin e Procedurave Standarde Operacionale.

Tiparet kyçe të projektit janë si vijon: (1) Theksim i rëndësishëm i vënies në funksion dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare në të tre rezultatet. (2) Projekti do të sjellë ndryshimin e këndvështrimit nga rimëkëmbja tek aspektet e përgatitjes dhe parandalimit sa i përket menaxhimit të fatkeqësive. (3) Ndërhyrjet do të sjellin ndryshime sektoriale përmes partneriteteve me institucionet e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror dhe vendor. (4) Projekti me një fazë të vetme prej katër vjetësh do të ketë qasje me dy momente: (i) gjatë periudhës së parë dy vjeçare, fokusi do të jetë tek reformimi i kuadrit ligjor për VDN dhe hartimin e PSV-ve për emergjencat civile, si dhe në përgatitjen e paketës gjithëpërfshirëse të trajnimit për VDN dhe pilotimin e trajnimit të inxhinierëve të ndërtimit në bashki, në një qark të përzgjedhur; (ii) gjatë periudhës vijuese prej dy vjetësh, do të realizohet shtrirja kombëtare e seancave të trajnimit gjithëpërfshirës për inxhinierët e ndërtimit të bashkive në të gjitha bashkitë, ndërkohë që do të organizohen edhe fushatat e ndërgjegjësimit për përgatitjen për fatkeqësitë në nivel vendor. (5) Duke qenë se Shqipëria është e ekspozuar ndaj përmbytjeve të shpeshta, projekti do të vlerësojë mundësinë e përfshirjes së VDN pas përmbytjeve në objektin e vet.

Sa i përket **mjedisit mundësues për VDN (rezultati 1)**: Projekti do të bashkëpunojë ngushtë me IN-it për ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për VDN në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në partneritet me AKMC-në, do t'i kushtohet vëmendje zbatimit të PSV-ve të reja për emergjencat civile. Këto masa për



reforma të politikave dhe ligjore do të hapin rrugën për ngritjen e një sistemi kombëtar që siguron se investimet për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë përforcojnë aftësitë ripërtëritëse të individëve, komuniteteve, vendit dhe pasurive të tyre, si dhe të vetë mjedisit.

Për sa i përket **institucioneve të forta dhe shërbimeve transparente (rezultati 2)**: Në fokus do të jenë veprimtaritë e ngritjes së kapaciteteve për IN-it dhe inxhinierët e ndërtimit në bashki për VDN-në, bazuar në planin e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për fuqinë punëtore të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë. Gjatë pjesës së parë do t'i ofrohet mbështetje një grupi prej dhjetë inxhinierësh nga IN-it, me qëllim hartimin e një pakete gjithëpërfshirëse trajnimi, udhëzimeve, instrumenteve pedagogjike dhe edukative për VDN-në. Projekti do të ndihmojë me shërbime të këshillimit teknik gjatë punës në vazhdim e sipër për riparimin dhe përf forcimin e ndërtesave të banimit. Ai do të ofrojë trajnim gjithëpërfshirës gjatë detyrës për grupin e ekspertëve të IN-it gjatë një programi shumë-javor trajnimi të trajnuesve. Me inxhinierët e ndërtimit të bashkive të një qarku do të organizohen trajnimet pilot për VDN-në që do të ndihmojnë në vlerësimin dhe përmirësimin e efektshmërisë dhe dixhitalizimit të materialeve të trajnimit. Gjatë pjesës së dytë, inxhinierëve të ndërtimit të të gjitha bashkive do t'u ofrohen seanca trajnimi të certifikuar dhe gjithëpërfshirëse.

Për sa i përket **ndërgjegjësimit publik lidhur me përgatitjen për fatkeqësi (rezultati 3)**: Në bashkëpunim me AKMC-në do të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi. Kjo strategji do të fuqizojë më tej njësinë e komunikimit të AKMC-së nëpërmjet bashkëpunimit me një shoqëri private për marrëdhëniet me publikun. Fushatat publike do të organizohen, me qëllim ndërgjegjësimin e popullsisë për riskun nga tërmetet, sjelljen e duhur gjatë tërmeteve, dhe vendosjen e kanaleve proaktive të komunikimit me institucionet e menaxhimit të fatkeqësive në nivel vendor dhe kombëtar.


Përdorimi i sistemit të vendit: Zbatimi i ndërhyrjeve që lidhen me tre rezultatet, do të bazohet në përdorimin e sistemit të vendit. IN-i do të sigurojë kontributin e tij në natyrë për projektin, në masën prej rreth 20%.

Strategjia për qëndrueshmërinë dhe përshkallëzimin: Pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga QSH-ja, ndryshimet e kuadrit ligjor për VDN-në garantojnë integrimin e tyre në sistemin kombëtar dhe detyrimin për zbatim në mbarë vendin. Zyrtarizimi i programit të certifikuar të trajnimit për VDN-në dhe strategjia publike për ndërgjegjësimin lidhur me përgatitjen për fatkeqësitë në IN-it dhe AKMC do të garantojnë zbatimin e tyre.

Shtojca 2: Buxheti në franga zvicerane (CHF)

Asistenca Teknike (AT)	Përshkrimi	Totali në CHF
AT 01	Kostot e projektit (IN)	914.000
AT 02	Kostot e projektit (IN)	257.000
AT 03	Kosto mbështetëse	134.000
AT 04	Shqyrtimi dhe Vlerësimi	60.000
SDC	Kësti i Transferuar	1.365.000
SDC	Kostot për Stafin e Ndihmës Humanitare të Zvicerës	446.400
Totali në CHF		1.811.400

Shtojca 3: Strategjia e Zbatimit të Projektit për Vlerësimin e Dëmeve në Ndërtesa





	Hali Shajpe Xhejll Arifi Dhurata Fatmir Flutura Liliana Mahmude Myzejen Safije Shpetim Valbona Zaide		Kullakshi Becaku Kullakshi Kamberi Kullakshi Kusi Ismaeli Kullakshi Ibrahimi Kullakshi Kullakshi Kullakshi Kullakshi																
2	Ali Bukunje Hamide Zyhra Svella Arben Edvana Elisabeta Elida Qesere	Maliq Maliq Abdulla Abdulla Svella Muhamet Hamit Hamit Hamit Maliq	Kullakshi Lahori Mema Kullakshi Tigani Kullakshi Medali Pala Nika Kullakshi	Timarë	8140	3/317	TRUALL	898	898	0	21	207	66.44	35,199.00	2,338/621.56				2,338/621.56
VLERA TOTALE																		5,510,755.44	

VENDIM**Nr. 479, datë 26.6.2026**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE
INDIVIDUALE TË BANIMIT NË
BASHKITË KURBIN DHE LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 327 350 000 (treqind e njëzet e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkitë Kurbin dhe Lezhë, të ndarë, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 30 100 000 (tridhjetë milionë e njëqind mijë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 297 250 000 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe i transferohet bashkive Kurbin dhe Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar

si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kurbin dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Albana Koçi**VENDIM****Nr. 480, datë 26.6.2026**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT
NË NDËRTESA (PALLAT), NË
BASHKITË KRUIJË E KURBIN, DHE
CAKTIMIN E BASHKIVE KRUIJË E
KURBIN SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjeve “i” e “iii”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 300 618 237,34 (treqind milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, për



financimin e riorcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të klasifikuar si objekte të pabanueshme, që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bazë të aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Krujë e Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 196 476 027 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 104 142 210, 34 (njëqind e katër milionë e njëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e dhjetë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe i transferohet bashkive Krujë e Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Krujë e Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

VENDIM
Nr. 481, datë 26.6.2026

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTEVE TË
NDËRHYRJEVE REHABILITUESE/
PËRSHTATËSE PËR NDËRHYRJET
STRUKTURALE TË NEVOJSHME PËR
OBJEKTET ME SHKALLË
DËMTUESHMËRIE DS4 NË BASHKINË
KURBIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 5 988 250 (pesë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, të nevojshme për kthimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar me shkallë dëmtueshmërie DS4 në Bashkinë Kurbin.

2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe i transferohet Bashkisë Kurbin në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

VENDIM
Nr. 483, datë 26.6.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
NDËRTIMIT DHE TË
RIKONSTRUKSIONIT TË
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, NË
ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 3/7, vlera “...18 584 271 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “ ... 864 086 (tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë ...”;

b) Pas pikës 3.7 shtohet pika 3.8, me këtë përmbajtje:

“3.8. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2026, në masën 17 720 185 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, i cili i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2026, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi” për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM

Nr. 484, datë 26.6.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 980, DATË 2.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIMIT, ZBATIMIT TË PUNIMEVE, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË QENDRËS SË SHËRBIMEVE DHE ADMINISTRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të

Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3/2, të vendimit nr. 980, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3/3, me këtë përmbajtje:

“3/3. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, për financimin e projektimit, të zbatimit të punimeve, të mbikëqyrjes dhe të kolaudimit të Qendrës së Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, të jetë në masën 158 747 529 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM

Nr. 485, datë 26.6.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË NJËJTIN TRUALL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të



Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 5.3, të vendimit nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 5.4, me këtë përmbajtje:

“5.4. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2026, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 287 812 166 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

VENDIM Nr. 487, datë 26.6.2026

PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË POSAÇËM TË KRIJUAR NGA VEPRIMTARITË E LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 52/1, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e rregullave e të procedurave për administrimin dhe përdorimin e fondit të posaçëm, të krijuar nga veprimtaritë e lojërave të fatit, në vijim “Fondi”, përfshirë procedurat e arkëtimit, verifikimit, financimit, monitorimit dhe kontrollit të përdorimit të fondeve.

2. Fondi administrohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF), i cili ushtron funksionet e administrimit teknik dhe financiar të fondit, pa cenuar kompetencat vendimmarrëse të organeve përkatëse (Këshilli i Mbështetjes së Projekteve) për miratimin e projekteve.

Për këtë qëllim, AMLF-ja:

a) administron llogarinë bankare të dedikuar të fondit;

b) regjistron, monitoron dhe ndjek të gjitha arkëtimet dhe pagesat e fondit;

c) mban regjistrin financiar të fondit dhe kryen rakordin periodik të të dhënave financiare me gjendjen e llogarisë bankare;

ç) evidenton detyrimet e papaguara dhe njofton subjektet përkatëse;

d) kryen verifikimin administrativ dhe financiar të dokumentacionit që lidhet me arkëtimin, administrimin dhe përdorimin e fondit;

dh) përgatit dokumentacionin për ekzekutimin e pagesave për projektet e miratuara, të cilat realizohen nëpërmjet sistemit të thesarit;

e) administron dhe ruan dokumentacionin përkatës;

ë) kontrollon dhe monitoron përdorimin e fondeve në përputhje me qëllimin e miratuar.

3. Burimet e financimit të fondit përbëhen nga të ardhurat e përcaktuara në nenet 52 dhe 52/1, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nga të ardhura të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për verifikimin e përmbushjes së detyrimeve financiare, që lidhen me fondin, AMLF-ja:

a) miraton dhe publikon formatin e faturës për arkëtim;

b) verifikon dokumentacionin financiar që shoqëron pagesat;

c) kërkon informacion shtesë dhe të dhëna verifikuese nga administrata tatimore dhe institucionet përkatëse, në rastet kur evidentohen mospërputhje, paqartësi ose pasaktësi në deklaratimet apo pagesat financiare të subjekteve përkatëse.

5. Administrata tatimore bashkëpunon me Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për verifikimin e saktësisë së pagesave, arkëtimeve dhe deklaratimeve financiare të subjekteve përkatëse.



6 Fondi përdoret vetëm për financimin e projekteve të miratuara nga Këshilli i Mbështetjes së Projekteve, i cili ushtron kompetencat vendimmarrëse për përzgjedhjen dhe miratimin e projekteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe qëllimet e përdorimit të fondit të përcaktuara në të.

7. Fondi nuk përdoret për:

a) shpenzime që nuk lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit të miratuar;

b) financimin e aktiviteteve që mbështeten njëkohësisht nga fonde të tjera buxhetore për të njëjtin qëllim.

8. AMLF-ja kryen administrimin dhe përgatitjen e ekzekutimit të pagesave për projektet e miratuara vetëm mbi bazën e:

a) vendimit të Këshillit të Mbështetjes së Projekteve;

b) kontratës së financimit të lidhur me përfituesin;

c) dokumentacionit justifikues financiar të paraqitur nga përfituesi.

9. Pagesat nga fondi kryhen nëpërmjet sistemit bankar, sipas fazave, kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e financimit.

10. Përfituesi i fondit ka detyrimin:

a) të përdorë fondet në përputhje me qëllimin e miratuar;

b) të administrojë dhe të ruajë dokumentacionin financiar të projektit;

c) të vërë në dispozicion të AMLF-së çdo informacion dhe dokumentacion të kërkuar për verifikim dhe monitorim.

11. Në rast të përdorimit të fondeve në kundërshtim me qëllimin e financimit, të mungesës së dokumentacionit justifikues ose të konstatimit të parregullsive gjatë monitorimit:

a) AMLF-ja pezullon menjëherë pagesat dhe kërkon kthimin e fondeve të përfituara në mënyrë të parregullt, si dhe, kur është rasti, ndërpret kontratën e financimit. Zgjidhja e kontratës së financimit kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi;

b) pas njoftimit me shkrim nga AMLF-ja për konstatimin e parregullsive dhe detyrimin për kthimin e fondeve, përfituesi është i detyruar të kthejë shumat përkatëse në llogarinë e fondit, brenda afatit të përcaktuar në njoftim. Në rast moskthimi brenda këtij afati, AMLF-ja ndërmer

procedurat për rikuperimin e detyrimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për detyrimet ndaj shtetit.

12. AMLF-ja publikon periodikisht në faqen zyrtare:

a) fondet e arkëtuara dhe shpenzimet e realizuara;

b) fondet e disbursuara;

c) listën e përfituesve të fondeve, shumën e financimit dhe qëllimin e çdo projekti të miratuar;

ç) raportin vjetor mbi administrimin financiar të fondit.

13. AMLF-ja kryen auditim të brendshëm për administrimin dhe përdorimin e fondit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

VENDIM
Nr. 489, datë 26.6.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 31, DATË 21.1.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2026, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 31, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2026, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)”, bëhen këto ndryshime:



a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2026, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 83 713 216 (tetëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

b) Pasqyra nr. 1 bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me pasqyrën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2026

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2026 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	55,827,345
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,940,525
3.	Shërbime e furniturë	17,202,960
4.	Investime	1,742,386
	TOTALI	83,713,216

VENDIM

Nr. 491, datë 26.6.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË MËNYRËS SË FUNKSIONIMIT TË BORDIT TË INSPEKTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 14, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të Bordit të Inspektimeve.

2. Në ushtrimin e detyrave dhe të përgjegjësisë të parashikuara në ligjin për inspektimin dhe në këtë vendim, Bordi i Inspektimeve udhëhiqet nga këto parime:

a) parimi i ligjshmërisë;

b) parimi i pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;

c) parimi i transparencës dhe informimit;

ç) parimi i mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit;

d) parimi i objektivitetit;

dh) parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit administrativ.

II. PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I BORDIT TË INSPEKTIMEVE

1. Bordi i Inspektimeve (në vijim, Bordi) krijohet pranë Inspektoratit të Përgjithshëm si organ bashkërendues e funksionon si strukturë e përhershme në përcaktimin e politikave dhe të standardeve të përgjithshme të inspektimit, për inspektoratet qendrore, vendore, si dhe për strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Bordi kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe inovacionin dhe ka në përbërje këta anëtarë:

a) ministrin përgjegjës për arsimin;

b) ministrin përgjegjës për mbrojtjen e territorit;

c) ministrin përgjegjës për turizmin dhe kulturën;

ç) ministrin përgjegjës për mjedisin;

d) ministrin përgjegjës për financën;

dh) ministrin përgjegjës për infrastrukturën dhe energjinë;

e) ministrin përgjegjës për bujqësinë;

ë) ministrin përgjegjës për shëndetësinë dhe mirëqenien sociale;

f) ministrin përgjegjës për pushtetin vendor.

3. Bordi ushtron detyrat dhe përgjegjësitë që i janë ngarkuar nga ligji nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ka kompetencat e mëposhtme:



a) Shqyrton dhe vlerëson raportin vjetor të Inspektoratit të Përgjithshëm mbi veprimtarinë inspektuese të inspektorateve qendrore;

b) Bashkërendon e orienton veprimtarinë e inspektimit në bashkëpunim me Inspektorin e Përgjithshëm;

c) Koordinon veprimtarinë e tij me Inspektorin e Përgjithshëm dhe shkëmben informacione në funksion të garantimit të standardeve të përgjithshme të inspektimit;

ç) Bashkëpunon me organet e tjera shtetërore, institucione ndërkombëtare, si dhe organizata të tjera me objekt veprimtarie ose ekspertizë në fushën e inspektimit;

d) Ndihmon ministrinë e linjës në bashkërendimin e punës për fushat e inspektimit;

dh) Shqyrton e miraton masat e nevojshme për mirorganizimin e mbledhjeve dhe të veprimtarive të Bordit, si dhe çdo kompetencë tjetër të nevojshme për organizimin e funksionimit të tij.

4. Kryetari i Bordit ushtron këto detyra:

a) cakton datën e zhvillimit të mbledhjes së Bordit dhe vendos rendin e ditës së çdo mbledhjeje;

b) drejton zhvillimin e mbledhjes së Bordit;

c) mbikëqyr veprimtarinë e sekretariatit teknik të Bordit;

ç) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

d) deklaron dhe u kërkon anëtarëve të Bordit, në mbledhjen e radhës, para votimit të çdo çështjeje, për të deklaruar konfliktin e interesit;

dh) u jep fjalën anëtarëve të Bordit për të relatuar për çështjet e ngarkuara;

e) nënshkruan vendimin e Bordit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

5. Anëtari i Bordit ushtron këto detyra:

a) merr pjesë në mbledhjet e Bordit ose njofton kryetarin për mosparaqitjen e tij dhe arsyet e mungesës;

b) deklaron gjendjen në kushtet e konfliktit të interesit;

c) voton për çështjet e rendit të ditës;

ç) merr fjalën dhe diskuton për çdo temë, objekt diskutimi;

d) relaton para Bordit çështjen, nëse është anëtari i caktuar si relator;

dh) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksionit;

e) nënshkruan vendimin e Bordit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

6. Bordi mbështetet nga sekretariati teknik, përbërja e të cilit caktohet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm.

7. Sekretariati teknik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) paraqet relacionin, lidhur me çështjet që do të trajtohen dhe dokumentacionin përkatës;

b) vendos në dispozicion të anëtarëve të Bordit, elektronikisht, çështjet që do të shqyrtohen në Bord, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së mbledhjes;

c) krijon kushtet për mbarëvajtjen e punës;

ç) përpilon dhe kryen njoftimet për mbledhjen e Bordit;

d) mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili zbardhet brenda 2 (dy) ditëve punë dhe nënshkruhet rregullisht nga anëtarët e Bordit dhe sekretariati teknik;

dh) zbardh vendimet e arsyetuara të marra nga Bordi dhe i ngarkon ato në sistemin elektronik “e-Inspektimi”.

III. THIRRJA E MBLEDHJES SË BORDIT TË INSPEKTIMEVE

1. Bordi mbledhet sa herë është i nevojshëm shqyrtimi i një çështjeje ose rasti, por jo më pak se 2 (dy) herë në vit. Kërkesa për thirrjen e mbledhjes përmban qëllimin, çështjet që do të diskutohen në mbledhje dhe materialet përkatëse.

2. Mbledhja e Bordit thirret me nismën e kryetarit të Bordit.

3. Çdo anëtar i Bordit dhe Inspektori i Përgjithshëm kanë të drejtë t'i kërkojnë me shkrim kryetarit të Bordit të thërrasë mbledhjen për çështje specifike dhe emergjente. Kryetari, nëse e vlerëson të arsyeshme, thërret mbledhjen e Bordit, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga depozitimi i kërkesës në sekretariatin teknik të Bordit. Kjo mbledhje shqyrton çështjen specifike, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, për të cilën është kërkuar mbledhja.

4. Mbledhjet e Bordit zhvillohen brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja e miratimit nga kryetari për thirrjen e mbledhjes së Bordit dhe kryerjes së njoftimit; përveç rasteve kur ka urgjencë, mbledhjet e Bordit zhvillohen me afat njoftimi më të shkurtër. Sekretariati teknik i Bordit u dërgon anëtarëve të Bordit, me postë elektronike ose me shkrim,



njoftimin dhe rendin e ditës për mbledhjen, si dhe materialet që do të shqyrtohen. Data e njoftimit të anëtarit të Bordit do të konsiderohet data e dërgimit të njoftimit.

5. Inspektori i Përgjithshëm është i pranishëm në çdo mbledhje të Bordit.

6. Mbledhja e Bordit, sipas pikës 2, të kreut IV, të këtij vendimi, në raste përjashtimore, mund të zhvillohet edhe në distancë (*online*). Në këtë rast, mënyra e thirrjes, organizimi i mbledhjes dhe vendimet miratohen sipas parashikimit në pikën 2, të kreut IV, të këtij vendimi.

7. Sekretariati teknik i Bordit përgatit njoftimin dhe rendin e ditës mbi bazën e materialeve të dorëzuara, si dhe i paraqet për konfirmim të kryetari i Bordit. Materialet, që paraqiten për shqyrtim në mbledhje, depozitohen pranë sekretariatit teknik të Bordit, i cili përgatit nga një kopje për secilin anëtar dhe ua dërgon në formë elektronike ose të printuar.

8. Në rast pamundësie objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengese ligjore të kryetarit, sipas përcaktimeve në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimet përgatitore, thirrja e mbledhjes dhe drejtimi kryhen nga anëtari i Bordit më i vjetër në moshë.

IV. PROCEDURA E MARRJES SË VENDIMEVE DHE E VOTIMIT NË MBLEDHJET E BORDIT TË INSPEKTIMEVE

1. Vendimmarrjet e Bordit konsultohen paraprakisht nga ministrat përgjegjës me institucionet dhe strukturat e tyre në varësi, që mbulojnë fushat përkatëse të përgjegjësisë shtetërore.

2. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtën e një vote. Në rastet kur nuk arrihet kuorumi i nevojshëm, mbledhja shtyhet dhe zhvillohet brenda 5 (pesë) ditëve punë nga dita e njoftuar më parë. Vendimi miratohet kur merret me shumicën e thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhjen e Bordit. Kur numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit të Bordit është përcaktuese në marrjen e vendimit dhe voton i fundit. Abstenimi nuk lejohet dhe çdo votë kundër argumentohet në procesverbal.

3. Bordi miraton vendime mbi bazën e dokumenteve të paraqitura për fushën inspektuese, por, në rastet kur e gjykon të nevojshme, ai merr vendime edhe mbi bazën e informacioneve të

paraqitura për shqyrtim apo të propozimeve të bëra gjatë diskutimit në mbledhje.

4. Vendimet e rekomandimet e miratuara nga Bordi janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha inspektoratet qendrore dhe institucionet e tjera inspektuese përgjegjëse për fushat përkatëse të inspektimit.

V. ZBARDHJA DHE PUBLIKIMI I VENDIMEVE TË BORDIT TË INSPEKTIMEVE

1. Zbardhja e vendimeve të Bordit bëhet nga sekretariati teknik i Bordit.

2. Vendimet e nënshkruara nga kryetari i Bordit depozitohen dhe regjistrohen në një libër të veçantë në zyrën e protokoll-arkivit të Inspektoratit të Përgjithshëm. Sekretariati teknik i Bordit dorëzon në protokoll procesverbalin dhe regjistrimet e mbledhjeve të Bordit.

3. Sekretariati teknik i Bordit u dërgon kopje të vendimeve të miratuara strukturave përkatëse, të cilat ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e tyre.

4. Pas zbardhjes së vendimeve të Bordit, brenda 5 (pesë) ditëve punë, sekretariati teknik i Bordit i publikon në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen kryetari, anëtarët e Bordit të Inspektimeve dhe Inspektorati i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Albana Koçiu



VENDIM

Nr. 493, datë 26.6.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 666, DATË 10.10.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT
NË MENSA E KONVIKTE DHE
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR
PËRFITIMIN E BURSIVE E TË
PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR, SI DHE FORMAT
E TJERA TË PËRKUJDESJES NDAJ
KATEGORIVE TË VEÇANTA NË
INSTITUCIONET ARSIMORE
PARAUNIVERSITARE PUBLIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”; të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar; të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar; të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar; të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe të ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të

ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 2.1, shtohet fjalia “Për nxënësit në arsimin profesional nuk zbatohet kushti i akomodimit në konvikte publike ...”;

b) Në pikën 3, pas fjalëve “... kategorive të mësipërme ...” shtohen fjalët “... në arsimin e përgjithshëm ...”;

c) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Për nxënësit në arsimin profesional zbatohen shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3. Humbja e bursës për rezultate shkollore zbatohet vetëm në rast përsëritjeje të vitit shkollor.”;

ç) Në pikën 7, fjalët “... (në vitin e parë) ...” hiqen;

d) Pas pikës 8 shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

“8/1. Në rastet kur numri i nxënësve që ndjekin arsimin e përgjithshëm, që plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës, është më i lartë se mundësitë e financimit të miratuara për atë vit shkollor dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të mbulojë me fondet e veta mbështetjen për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret, njësia e vetëqeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, përcakton rregullat për shpërndarjen e bursave dhe gjysmëbursave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.”;

dh) Në fund të pikës 10 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“... Bursë përfitojnë edhe nxënësit në klasën XI e lart, që nuk kanë përfituar bursë në vitin e parë dhe përmbushin kriteret, sipas këtij vendimi.”;

e) Pika 10.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10.1. Bursat e nxënësve për klasën XI e lart, në arsimin profesional, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga këshilli bashkiak, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku ata ndjekin arsimin. Rishqyrtimi përfshin edhe nxënësit që përfitojnë për herë të parë bursë në klasën XI e lart, në rastet kur plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim.”;

ë) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“12. Të gjithë nxënësit/prindërit paraqesin kërkesat për përfitimin e bursës pranë drejtorive të institucioneve arsimore, të cilat dokumentojnë me procesverbal pranimin e tyre, dhe një kopje e procesverbalit i jepet kërkuarit. Drejtoritë e institucioneve arsimore, për nxënësit që regjistrohen për herë të parë në klasën X, të cilët përfitojnë bursë sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi, i dërgojnë zyrtarisht kërkesat për miratimin e bursës në njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të përhershëm të nxënësit. Për nxënësit e klasave të tjera, që kanë përfituar më parë bursa, depozitojnë dokumentacionin për vijimin e përmbushjes së kritereve.”;

f) Pika 14/1 shfuqizohet;

g) Pas pikës 15 shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

“15/1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dorëzojnë kërkesat për fondet e bursave brenda muajit mars.”;

gj) Pas pikës 22 shtohet pika 22/1, me këtë përmbajtje:

“22/1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, me fondet e tyre buxhetore apo transfertës nga buxheti i shtetit, për institucionet arsimore parauniversitare publike në territorin që mbulojnë, kanë të drejtë të ofrojnë shërbimin e ushqimit për nxënësit, në përputhje me standardet dhe rregullat e miratuara nga autoritetet përgjegjëse për ushqimin.”;

h) Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të bursave administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave dhe konvikteve, ku nxënësit ndjekin mësimet. Pagesa mujore e bursës bëhet sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Nxënësit përfitojnë kuotat financiare (bursa), sipas normave në natyrë për ushqimin e nxënësve në konvikte dhe shpenzimeve vetjake, sipas pasqyrës nr. 3. Masa e bursës përlllogaritet si prodhim i kuotës ushqimore me ditë qëndrimin në konvikt, për jo më shumë se 10 (dhjetë) muaj kalendarikë, në proporcion me ditë qëndrimin në konvikt;

b) Nxënësit që nuk jetojnë në konvikt dhe që plotësojnë kriteret për bursë përfitojnë vlerën e plotë të bursës mujore, e cila u paguhet pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të prindit/prindërve ose përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësit çdo muaj, brenda datës 10 (dhjetë) të

muajit pasardhës. Masa e bursës për këtë kategori jepet në pasqyrat nr. 2, për arsimin e përgjithshëm, dhe nr. 2/1, për arsimin profesional, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”;

i) Pas pikës 23 shtohet pika 23/1, me këtë përmbajtje:

“23/1. Në rastet kur fondet e disponueshme të njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kërkesat e pranuar, njësia e vetëqeverisjes vendore miraton gjysmë bursë, me vlerë 50% të kuotës së plotë mujore, duke respektuar rendin e përparësisë së kritereve të përcaktuara në këtë vendim dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i NjVv-së.”;

j) Pas pikës 30 shtohet pika 30/1, me këtë përmbajtje:

“30/1. Duke filluar nga viti 2027, kuota mujore e bursës për të gjithë përfituesit, sipas pikave 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, të këtij vendimi, indekssohet çdo vit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të normës vjetore të inflacionit të publikuar nga INSTAT-i për vitin paraardhës. Ministritë përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe atë profesional përlllogaritin fondin e nevojshëm të bursave, përfshirë edhe indeksimin, dhe njoftojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për masën e normës së inflacionit që do të aplikohet, në përputhje me pasqyrat që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si dhe me normën vjetore të inflacionit të publikuar nga INSTAT-i.”;

k) Pika 29 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“29. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional jep në total jo më pak se 5 000 (pesë mijë) bursa në vit për nxënësit e arsimit profesional, nga të cilat 2 500 (dy mijë e pesëqind) bursa janë të dedikuara për hyrjet e reja në shkollat profesionale të sistemit arsimor publik.”;

l) Pika 33 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“33. Vendimet e këshillave të njësisë së vetëqeverisjes vendore miratohen, sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim. Vendimet e këshillave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të miratuara përtej afateve, përballohen me fondet e tyre.”;

ll) Pasqyrat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me pasqyrat nr. 1, nr. 2, dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;



m) Pas pasqyrës nr. 2 shtohet pasqyra nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e sistemit arsimor parauniversitar dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare duke filluar nga viti shkollor 2026–2027.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

PASQYRA NR. 1
KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmëbursa	Me pagesë
		Me të ardhura mujore, lek/frymë	Me të ardhura mujore, lek/frymë	Me të ardhura mujore, lek/frymë
1	Për familjet me 2 persona	deri 5 000	5 000–5 500	mbi 5 500
2	Për familjet me 3 persona	deri 4 700	4 700–5 300	mbi 5 300
3	Për familjet me 4 persona	deri 4 600	4 600–5 100	mbi 5 100
4	Për familjet me 5 persona	deri 4 500	4 500–5 000	mbi 5 000
5	Për familjet me 6 persona	deri 4 300	4 300–4 800	mbi 4800
6	Për familjet me 7 persona	deri 4 000	4 000–4 700	mbi 4 700
7	Për familjet me 8 persona	deri 3 700	3 700–4 500	mbi 4 500

PASQYRA NR. 2
MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT (NË LEK) NË ARSIMIN E PËRGJITHSHËM QË NUK JETOJNË NË KONVIKT (NË LEK)

Nr.	Kategoritë e shkollave	Masa mujore e bursës për nxënësit që plotësojnë kriteret 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme	
	a) Bursa	7 500
	b) Gjysmëbursa	3 750
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive e Arsimit Special	
	a) Bursa	9 100
	b) Gjysmëbursa	4 550
	c) Me pagesë	-
3	Për nxënësit jetimë	9 000

PASQYRA NR. 2 /1
MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT NË ARSIMIN E MESËM TË ARSIMIT PROFESIONAL (NË LEK)

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Masa mujore e bursës për nxënësit që plotësojnë kriteret 2.2; 2.3 dhe 2.4	Masa mujore e bursës për nxënësit që plotësojnë kriterin ekonomik (kuotë ushqimore)	Shpenzime vetjake (higjienë personale, mjete mësimore)	Totali i financimit nga shteti për masën mujore të bursës për nxënësit që plotësojnë kriterin ekonomik (kuotë ushqimore)
1	Shkollat e mesme profesionale				
	a) Bursa	10 000	9 300	700	10 000
	b) Gjysmëbursa	5 000			5 000
	c) Me pagesë	0	9 300	700	10 000



PASQYRA NR. 3
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE NË KONVIKT
DHE SHPENZIMET VETJAKE

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energj. (kcal)	Çmimi i ri (lek/kg)	Vlera ditore (lek)
1	Bukë	gram	375	977	120	45
2	Makarona	gram	30	107	208	6
3	Oriz	gram	30	109	186	6
4	Sheqer	gram	40	157	90	4
5	Fasule	gram	30	93	300	9
6	Perime	gram	130	27	200	26
7	Fruta	gram	100	42	160	16
8	Vaj	gramë	30	270	200	6
9	Gjalpë	gram	20	152	900	18
10	Mish	gram	75	115	956	72
11	Djathë	gram	25	40	1,100	28
12	Reçel	gram	20	93	240	5
13	Vezë	kokërr	1	42	24	0
14	Qumësht	gramë	200	98	140	28
15	Patate	gram	200	170	78	16
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	953	29
Kuota ditore ushqimore						312
Shpenzime vetjake (higjienë personale, mjete mësimore) → 650 lek/muaj						22
TOTALI MUJOR (vlera ditore × 30 ditë + shpenzime vetjake)						10,000

VENDIM
Nr. 495, datë 26.6.2026

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit,
Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 707, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE SHKODËR–FIER”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të

VENDOSI:

1. Në pikën 20 të shtojcës, që i bashkëlidhet vendimit nr. 707, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër–Fier”, të ndryshuar, shtohet prona e paluajtshme me nr. 284/5, me vendndodhje në zonën kadastrale 3774, sipas të dhënave të përcaktuara në shtojcën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim përdorimin për zhvillimin e qëndrueshëm në turizëm.



2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi

SHTOJCË

20. Zona kadastrale 3774, Kavajë
(Vilë Bashtovë)

ZK	Nr. pasurie	Vol.	Faqe	Lloji	Sip. m ² ose ha	Pronësia
3774	284/5	13	25	ranore	294 845	shtet

UDHËZIM
Nr. 398, datë 3.6.2026

PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT,
EMËRIMIT, PEZULLIMIT, LIRIMIT
DHE TË DISIPLINËS SË MJEKËVE NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE
PUBLIKE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, NËPËRMJET
PLATFORMËS ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 31/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të pikave 10 dhe 11, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 4.7.2018, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin, emërimin, pezullimin, lirin dhe disiplinën e mjekëve në institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik, nëpërmjet portalit “Mjek për Shqipërinë”.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, termi “mjek” do të përfshijë të gjithë profesionistët e shëndetësisë që

janë të licencuar për ushtrimin e profesionit nga Urdhri i Mjekut apo Urdhri i Stomatologut dhe që ushtrojnë profesionin e tyre.

3. Në kuptim të këtij udhëzimi, institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor publik përfshijnë: spitalet universitare/terciare / rajonale / psikiatrike/bashkiake/ditore, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor (këtu e më poshtë “NJVKSH-të”), qendrat shëndetësore (këtu e më poshtë “QSH-të”), si dhe institucionet qendrore në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që kanë në organikat e tyre pozicionin “mjek”.

4. Marrëdhëniet e punës së mjekëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

5. Procedurat për punësimin e mjekëve udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të shëndetit publik.

6. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mjek për Shqipërinë”.

7. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim “DQOSHKSH-ja”) është institucioni përgjegjës për menaxhimin e portalit “Mjek për Shqipërinë”. Për pranimin e mjekëve në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore publike, DQOSHKSH-ja në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (në vazhdim “DROSHKSH-të”), drejtoritë e spitaleve universitare/(në vazhdim “DSU-të”)/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së respektivisht, organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

8. DROSHKSH-të, DSU-të/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së që kanë në organikat e tyre pozicionin “mjek” kanë detyrimin të përcjellin pranë DQOSHKSH-së vendet e lira sa herë krijohen.

9. DQOSHKSH-ja ka detyrimin t’i publikojë vendet e lira në portalin “Mjek për Shqipërinë”, si dhe përditësimin e listëpritisjes, në rast se ka një të tillë. Publikimet e vendeve të lira në portal do të bëhen menjëherë me krijimin e vendit vakant.

10. Për të marrë pjesë në Programin e Bonusit mjeku aplikon përmes platformës elektronike “Mjekë për Shqipërinë”, ndërfaqja “Mjekë bonus”.



11. Mjekët nga diaspora, shprehin interesin për punësim në rubrikën “Mjek nga Diaspora” në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

12. Procesi i konkurrimit zhvillohet për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin për ushtrimin e profesionit të mjekut, si dhe kriteret specifike të pozicionit të punës.

13. Kandidatët e interesuar për t'u punësuar si mjekë në institucionet shëndetësore publike marrin pjesë në konkurrim, i cili zhvillohet në dy faza:

- a) konkurrimi me dosje;
- b) intervista.

KREU II

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS DHE APLIKIMI

1. Institucionet e Ofrimit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor Publik në varësi të OSHKSH-së raportojnë vendet e lira të punës, menjëherë me krijimin e pozicionit vakant, pranë DROSHKSH-ve. DROSHKSH-të identifikojnë vendet vakante për (mjek) në institucionet shëndetësore në varësi të tyre dhe i dërgojnë pranë DQOSHKSH-së, brenda datës 2 (dy) të çdo muaji pasardhës.

2. Qendrat Spitalore Universitare/terciare identifikojnë vendet vakante për mjekë sipas shërbimeve dhe përgatisin shpalljen. Këto të fundit dërgojnë shpalljen e vendeve të lira pranë DQOSHKSH-së, brenda datës 2 të çdo muaji pasardhës.

3. DQOSHKSH-ja, ka përgjegjësinë për të raportuar listën përfundimtare të vendeve vakante në MSHMS, brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji pasardhës.

4. Shpallja e vendeve vakant për mjek familje/mjek të përgjithshëm bëhet e grupuar mbi bazë të NJVKSH-ve. Shpallja e vendeve vakante për mjek specialist/mjek stomatolog bëhet për pozicion, sipas specialitetit përkatës.

5. Shpallja në portalin “Mjek për Shqipërinë” përmban këto të dhëna:

- a) kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranim;
- b) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
- c) afatin e dorëzimit të dokumenteve;
- d) datën e shpalljes së vlerësimit paraprak të kandidatëve;

e) fushën e njohurive mbi të cilën do të bazohet intervista;

f) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për fazat I dhe II;

g) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët;

h) lista e qendrave shëndetësore e grupuar, sipas NJVKSH-ve (për mjek të përgjithshëm/mjek familje).

6. Kandidatët e interesuar, regjistrohen në portalin “Mjek për Shqipërinë” dhe ngarkojnë/përditësojnë në portal dokumentet e kërkuara.

7. Dosja e aplikimit përmban:

- a) jetëshkrimin e kandidatit (CV);
- b) fotokopje të letërnjoftimit (ID) ;

c) diplomën universitare dhe listën e notave (për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga ministria përgjegjëse për arsimin);

d) diplomën e specializimit dhe listën e notave (nëse pozicioni i punës është për “Mjek specialist”). Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit aplikohen të njëjtat kërkesa si shkronja “c” më sipër;

e) lejen e ushtrimit të profesionit brenda afatit të vlefshmërisë;

f) fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë dhe gjeneralitetet e kandidatit);

g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

i) vërtetim nga UMSH-ja që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Çdo dokumentacion tjetër që vërteton, trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

8. Kandidatët, të cilët janë të punësuar në një institucion shëndetësor publik, nuk mund të konkurrojnë nëpërmjet kësaj platforme.

9. Mjekët specialistë me kuotë të lirë apo të mbuluar nuk mund të konkurrojnë nëpërmjet platformës, pa përfunduar specializimin.

10. DQOSHKSH-ja përcjellë pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë vakancat e raportuara nga spitalet universitare/terciare dhe institucionet e tjera shëndetësore në rrugë elektronike para çdo publikimi.

11. Përjashtimisht, në rastet kur ministria përgjegjëse për shëndetësinë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse (OJF), mjekët e angazhuar në kuadër të këtyre



marrëveshjeve, në përfundim të zbatimit të tyre, kanë prioritet për t'u përfshirë brenda sistemit publik shëndetësor, përmes transferimit nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në një nga vendet që rezultojnë vakante. Në transferimet e këtyre mjekëve do të mbahet në konsideratë përvoja e tyre e punës pranë OJF-ve.

KREU III KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë:

a) DQOSHKSH-ja krijon komisionet *ad hoc* për vlerësimin e kandidatëve për mjek në spitalet rajonale/bashkiake/ditore, NJVKSH-të dhe në qendrat shëndetësore, duke caktuar kryetarin dhe anëtarët, me përbërjen, si më poshtë:

1) një përfaqësues nga DQOSHKSH-ja;

2) një përfaqësues nga DROSHKSH-ja;

3) shefi i shërbimit ose një përfaqësues (mjek) nga shërbimi spitalor dhe për qendrat shëndetësore një përfaqësues nga NJVKSH-ja;

b) Titullari i spitaleve universitare/terciare dhe institucioneve qendrore në varësi të MSHMS-së krijojnë komisionet për vlerësimin e kandidatëve për mjek në institucionet respektive, duke caktuar kryetarin dhe anëtarët, me përbërjen si më poshtë:

1) drejtori/nëndrejtori;

2) shefi i shërbimit/mjek në shërbimin përkatës;

3) një përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore.

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij kreu, kryen rolin e Sekretariatit Teknik të platformës “Mjek për Shqipërinë” për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

Sekretariati Teknik i platformës “Mjek për Shqipërinë” kryen detyrat e mëposhtme:

a) administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portalin “Mjek për Shqipërinë”;

b) kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit të depozituar në përputhje me kërkesat e dosjes së aplikimit të përcaktuara në kreun II, pika 5, të këtij udhëzimi;

c) i vë në dispozicion Komisionit të Vlerësimit, listën e kandidatëve dhe informacionin mbi verifikimin paraprak të dokumentacionit të dosjes së aplikimit;

d) dërgon për publikim në platformën “Mjek për Shqipërinë” pranë DQOSHKSH-së emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimit, si dhe i njofton ata për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të fazës II;

e) njofton nëpërmjet postës elektronike, kandidatët e kualifikuar për vlerësimin e dosjes ashtu edhe ata të cilët nuk janë kualifikuar duke specifikuar qartësisht dhe në mënyrë të kuptueshme arsyet e moskualifikimit;

f) administron ankesat dhe ja paraqet Komisionit për shqyrtim;

g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH vendimin përfundimtar të Komisionit për renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit;

h) dërgon procesverbalet dhe materialet e tjera të konkurrimit pranë drejtorive rajonale të OSHKSH-së apo drejtorisë së institucionit përkatës;

i) Sekretariati Teknik plotëson formularin e inventarit të dokumenteve të ngarkuara *online* nga kandidati dhe formularin e inventarit të procedurës sipas periudhave të aplikimit (shtojcat nr. 5 dhe nr. 6).

2. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët (shtojca 2).

3. Komisioni i Vlerësimit kryen detyrat, si më poshtë:

a) kryen vlerësimin me pikë të dokumentacionit të çdo aplikanti, në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) përgatit pyetjet për intervistën e strukturuar dhe kryen intervistimin e kandidatëve, në përputhje me fushën e njohurive të publikuara në platformën “Mjek për Shqipërinë”, si dhe kryen vlerësimin me pikë të intervistës;

c) kandidatët njoftohen se intervista e strukturuar me gojë do të regjistrohet me zë. Deklarata e pranimit ose e mospranimit për të regjistruar intervistën e strukturuar me gojë duhet të nënshkruhet nga kandidatët. Kjo deklaratë duhet të përfshijë detyrimin nga ana e Komisionit për të ruajtur fshehtësinë e të dhënave të kandidatit. Nëse kandidati refuzon të nënshkruajë deklaratën, atëherë intervista me gojë nuk regjistrohet;

d) kryen vlerësimin përfundimtar dhe renditjen e kandidatëve;



e) organizon procesin e përzgjedhjes së vendeve vakante pranë DROSHKSH-së/institucioneve të tjera pjesë integrale e këtij udhëzimi.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë njoftohet për çdo mbledhje të komisioneve dhe ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues.

KREU IV VLERËSIMI DHE EMËRIMI

1. Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, gjuhën e huaj, përvojën në shëndetësi, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për intervistën me gojë.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 50 pikë, përkatësisht:

a) Për mjekë të përgjithshëm:

- deri në 45 pikë vlerësimi i dosjes;

- deri në 5 pikë intervista.

b) Për mjekë specialist:

- deri në 40 pikë vlerësimi i dosjes;

- deri në 10 pikë intervista.

c) Për mjekë specialist në spitale terciare dhe universitare:

- deri në 30 pikë vlerësimi i dosjes;

- deri në 20 pikë intervista.

Regjistrimi audio i intervistës me gojë lejohet vetëm pas dhënies së pëlqimit paraprak me shkrim nga kandidati.

Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Kualifikimi i kandidatëve për fazën e vlerësimit:

a) Sekretariati teknik i platformës “Mjek për Shqipërinë” bën verifikimin e dosjes së kandidatëve dhe konstaton nëse janë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara, sipas shpalljes së vendit të lirë. Brenda 24 orëve (1 ditë pune) pas përfundimit të afatit të aplikimit për mjekun specialist dhe pas çdo aplikimi në rastin e mjekut të përgjithshëm, Sekretariati Teknik kryen verifikimin paraprak të dokumentacionit, sipas shtojcës nr. 6. Sekretariati dërgon për publikim në platformën “Mjek për Shqipërinë” pranë DQOSHKSH-së emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e pranimit, si dhe përcakton vendin, datën dhe orën e zhvillimit të fazës II të konkurrimit;

b) Në të njëjtën ditë me publikimin e listës, Sekretariati Teknik i platformës “Mjek për

Shqipërinë” njofton nëpërmjet postës elektronike, kandidatët e kualifikuar për vlerësimin e dosjes, gjithashtu, edhe ata të cilët nuk janë kualifikuar, duke arsyetuar shkaqet e skualifikimit;

c) Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit të vlerësimit, brenda 48 orëve që nga marrja e njoftimit me *email*, në ndërfaqen “Ankesa ime” të platformës elektronike ose në adresën elektronike zyrtare nëpërmjet së cilës janë bërë me dije për vlerësimin apo moskualifikimin, dhe/ose me shkresë drejtuar Komisionit të Vlerësimit. Pas përfundimit të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i Vlerësimit, në rast se një nga kandidatët do të kualifikohet, Sekretariati Teknik i platformës “Mjek për Shqipërinë” merr masat për ta përfshirë kandidatin në listën e të kualifikuarve, duke vënë në dijeni dhe kandidatin.

3. Komisioni i Vlerësimit kryen vlerësimin e dosjes së kandidatëve brenda tri ditëve pune nga momenti që i është vënë në dispozicion dokumentacioni i verifikuar paraprakisht nga Sekretariati Teknik (shtojca nr. 1).

4. Komisioni i vlerësimit përgatit pyetjet për intervistën e strukturuar me gojë dhe e zhvillon atë me të gjithë kandidatët brenda ditës, në datën e përcaktuar në njoftimin e publikuar në portal. Në përfundim hartohet lista me pikët totale për çdo kandidat dhe, brenda 24 orëve, Sekretariati Teknik i platformës “Mjek për Shqipërinë” i njofton ata për rezultatin, nëpërmjet adresës së tyre me *email*.

5. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit të vlerësimit brenda 48 orëve që nga marrja e njoftimit me *email*, në ndërfaqen “Ankesa ime” ose në adresën elektronike zyrtare nëpërmjet së cilës janë bërë me dije për vlerësimin apo moskualifikimin dhe/ose me shkresë drejtuar Komisionit të Vlerësimit. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni dërgon tek autoriteti përgjegjës për emërimin, raportin dhe vendimin përfundimtar për renditjen e kandidatëve (shtojcat nr. 3, dhe nr. 4).

6. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i ditur ankimuesit, me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike.

7. Pas përfundimit të afateve të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Vlerësimit shpall renditjen e kandidatëve dhe e dërgon pranë DQOSHKSH-së, e cila menjëherë bën publikimin në portalin “Mjek për Shqipërinë”.

8. Spitalet universitare/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së, bazuar në



statutet/rregulloret e tyre, mund të vendosin një kufi minimal pikësh për t'u konsideruar kandidat fitues. Ky kufi minimal pikësh publikohet në shpalljen e vendit të lirë.

9. DQOSHKSH-ja cakton menjëherë orarin dhe vendin për paraqitjen e kandidatëve për përzgjedhjen e vendit/vendeve vakante pas 72 orëve nga publikimi i renditjes së kandidatëve për mjekët specialistë dhe brenda 72 orëve nga publikimi i vendit/vendeve vakant për mjek të përgjithshëm/mjek familje. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të lartë të pikëve, ka të drejtën për të qenë i pari në përzgjedhjen e vendit të lirë të punës në institucionet shëndetësore përkatëse. Kandidati duhet të paraqitet fizikisht pranë vendit të përcaktuar nga DQOSHKSH-ja për përzgjedhjen e vendit vakant dhe në rast mospërzgjedhjeje, vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Në rastin e mjekut të përgjithshëm apo të mjekut të familjes, kandidati që nuk përzgjedh mbetet në listë pritje për 6 (gjashtë) muaj.

10. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, nëse ka të tillë, nëse nuk ka PAK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka mesataren më të lartë në listën e notave të diplomës universitare.

11. DROSHKSH-ja dërgon aktin e emërimit pranë institucionit për të cilin kandidati fitues ka përzgjedhur vendin e punës në institucionet në varësi të OSHKSH-së, brenda 5 ditëve pune. Institucioni në të cilin shkon emërimi, maksimalisht brenda 3 ditëve pune nga njohja me aktin e emërimit, njofton kandidatin të paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të lidhur kontratën individuale të punës. Titullari i institucionit lidh kontratën e punës me mjekun fitues.

12. Spitalet universitare/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së nxjerrin aktin e emërimit për fituesin. Kandidati i shpallur fitues lidh kontratë individuale pune me institucionin shëndetësor.

13. OSHKSH-ja/spitali universitar/terciar dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së dokumentojnë procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raportojnë brenda 5 ditëve të para të punës së çdo muaji, me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në MSHMS-së

për emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.

14. Kandidatët mjek familje/mjek të përgjithshëm, të cilët nuk përzgjedhin, qëndrojnë në listën e pritjes për një periudhë maksimalisht 6 (gjashtë) muaj për një vend pune në NJVKSH ku është kualifikuar dhe thirren për përzgjedhje të vendeve vakante sapo të ketë shpallje të reja.

15. Në përfundim të afateve të konkurritimit në rast se për një pozicion mjek specialist nuk ka pasur kandidat fitues, ky njoftim hiqet nga portali dhe mund të publikohet përsëri pasi të rivlerësohet pozicioni.

16. Spitalet universitare/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së dërgojnë listën me emrat e fituesve pranë DQOSHKSH-së. Kjo e fundit ka detyrimin të publikojë menjëherë në portalin “Mjek për Shqipërinë” këto lista, si dhe emrat e mjekëve që përzgjedhin vendin e punës për institucionet në varësi të OSHKSH-së.

17. Në rastin e krijimit të vendeve të lira të përkohshme, pozicionet plotësohen nga kandidatët fitues në listë pritje, të cilët njoftohen sipas renditjes me pikë. Kandidatët të cilët kanë përzgjedhur një vend pune si zëvendësues, për mjek familje/mjek të përgjithshëm (leje barrëldije, pezullime etj.), thirren për përzgjedhje sa herë krijohen vende të lira pune. Në rast se gjatë periudhës së punës si zëvendësues nuk punësohen në një pozicion definitiv, me përmbushjen e kontratës kalojnë në listëpritje sipas renditjes së tyre me pikë. Përvoja e punës si provizor përlllogaritet për efekt pikëzimi.

18. Kërkesat për transferim të mjekëve, shqyrtohen dhe miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

KREU V ANKIMIMI, KONTROLLI DHE VERIFIKIMI

1. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit të vlerësimit sipas fazave, brenda 48 orëve që nga marrja e njoftimit me *email*, në ndërfaqen “Ankesa ime” ose në adresën elektronike zyrtare nëpërmjet së cilës janë bërë me dije për vlerësimin apo moskualifikimin dhe/ose me shkresë drejtuar DROSHKSH-së përkatëse.

2. Komisioni i Vlerësimit shqyrton ankesat dhe i kthen përgjigje ankimuesit, brenda 72 orëve



nëpërmjet postës elektronike të publikuar në shpallje.

3. Për ankesat, të cilat vijnë dhe pas kthim përgjigjes nga Komisioni i Vlerësimit, lidhur me proceset e rekrutimit të zhvilluara pranë:

a) DROSHKSH-së – kandidatit i lind e drejta të ankimohet pranë DQOSHKSH-së. Komisioni *ad hoc* për shqyrtimin e ankesave (KSHA) ngrihet pranë DQOSHKSH-së, me përbërjen si më poshtë:

- 1) një përfaqësues nga DQOSHKSH-ja: kryetar;
- 2) një përfaqësues nga DROSHKSH-ja: anëtar;
- 3) një përfaqësues (mjek) nga shërbimi spitalor ose NJVKSH-ja: anëtar;

b) Spitalet universitare/terciare dhe institucionet qendrore në varësi të MSHMS-së. Kandidatit i lind e drejta të ankimohet pranë drejtorisë së institucionit përkatës. Komisioni i shqyrtimit të ankesave (KSHA) ngrihet nga titullari i institucionit me anëtar të ndryshëm nga përbërja e komisionit që ka bërë vlerësimin e kandidatit.

4. DQOSHKSH-ja është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e procedurave të punësimit për institucionet në varësi të saj.

5. DQOSHKSH-ja bën me dije ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë në çdo rast të konstatimit të shkeljeve në procedurat e ndjekura sipas këtij udhëzimi.

6. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë monitoron dhe kontrollon periodikisht procedurat e punësimit në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

KREU VI PROCEDURA E PUNËSIMIT TË MJEKËVE NGA DIASPORA

1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë krijon dhe administron një rubrikë “*Mjek nga Diaspora*” në faqen zyrtare të saj, në të cilën mjekët nga diaspora regjistrohen dhe shprehin interesin për t’u punësuar në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, “Mjek nga diaspora” konsiderohet mjeku që ka kryer studimet universitare dhe/ose specializimin jashtë Republikës së Shqipërisë, ose që ka ushtruar apo ushtron profesionin për të paktën 2 (dy) vite në institucione shëndetësore në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian ose OECD-së.

3. Aplikimi konsiderohet i vlefshëm nëse periudha nga momenti i diplomimit ose shkëputjes

nga marrëdhënia e punës jashtë vendit nuk kalon 12 muaj.

4. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, mbi bazën e nevojave të sistemit shëndetësor publik, identifikon vendet vakante në përputhje me profilin e mjekut aplikant dhe ngre me urdhër të Titullarit komisionin *ad hoc* të vlerësimit, të përbërë nga:

- 1) Një përfaqësues i caktuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë (në cilësinë e kryetarit);
- 2) Një përfaqësues nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) ose nga institucioni shëndetësor pritës ku ndodhet vendi vakant;

3) Një përfaqësues nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në ministri.

5. Vlerësimi kryhet sipas rastit, në përputhje me pikën 1 të Kreut IV të këtij udhëzimi.

6. Mjeku i përzgjedhur ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin e kërkuar ligjor përpara lidhjes së kontratës/marrëdhënies së punës.

7. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse ligjore (Urdhrin e Mjekut dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin) mundëson ndjekjen e një procedure të përsheptuar për verifikimin e dokumentacionit, njohjen e diplomave dhe pajisjen me licencë për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.

8. Mjekët e punësuar sipas këtij kreu gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime si mjekët e tjerë të punësuar në institucionet shëndetësore publike.

KREU VII PLOTËSIMI I VENDEVE VAKANTE NËPËRMJET PROGRAMIT TË BONUSIT

1. Për raste të veçanta të mungesës së mjekut specialist në shërbime të ndryshme të spitaleve rajonale, bashkiake dhe ditore apo në rastet e mungesës së mjekut të përgjithshëm pranë shërbimit të urgjencës në spitalet bashkiake, me propozim të DQOSHKSH-së, ministri përgjegjës për shëndetësinë kontraktin për një periudhë të caktuar mjek specialist apo mjek të përgjithshëm për mbulimin e shërbimit të munguar.

2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë përgatit shpalljen për ata mjek, për të cilët do të aplikohet Programi i Bonusit, e dërgon për publikim në portalin “*Mjek për Shqipërinë*” në ndërfaqen “*Mjek me bonus*” dhe njëkohësisht e publikon atë në faqen zyrtare të MSHMS-së.



3. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit mund të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike ose mund të vijnë nga jashtë sistemit publik shëndetësor.

4. Për aplikim nevojitet:

a) kërkesa për shprehje interesi;

b) vërtetimi i punësimit nga institucioni shëndetësor ku punon, si dhe leje nga institucioni për pjesëmarrje në Programin e Bonusit (kur mjeku është i punësuar në institucionet shëndetësore publike);

c) diploma e specialitetit ose e mjekësisë së përgjithshme;

d) licenca e ushtrimit të profesionit brenda afatit të vlefshmërisë;

e) jetëshkrimi i kandidatit (CV).

5. MSHMS-ja krijon Komisionin e Vlerësimit për aplikantët në Programin e Bonusit. Komisioni i vlerësimit administron dokumentet e aplikantëve, zhvillon intervistën me kandidatët dhe zgjedh fituesin mbi bazën e përcaktimeve të urdhrit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

6. Mjeku që përzgjidhet për Programin e Bonusit lidh kontratë me MSHMS-në, me institucionin shëndetësor ku do të punojë dhe me drejtorinë rajonale të FSDKSH-së.

7. Në përfundim të kontratës mjeku kthehet në vendin e mëparshëm të punës për rastet kur vjen nga sistemi shëndetësor publik.

8. Në zbatim të sistemit të referimit për konsulta dhe ndërhyrje kirurgjikale në spitale të tjera, dërgimi i mjekëve specialist, nga një spital universitar/terciar në një spital rajonal/bashkiak, miratohet nga MSHMS-ja, dhe nga një spital rajonal në një tjetër spital rajonal apo bashkiak/ditor miratohet nga drejtoria qendrore e OSHKSH-së.

KREU VIII

MASA DISIPLINORE, PEZULLIMI DHE LARGIMI NGA PUNA I MJEKËVE

1. Procedura disiplinore ndaj mjekut fillon nga drejtori/titullari i institucionit ku është i punësuar.

2. Shkeljet disiplinore si rregull përcaktohen në kontratën kolektive të punës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar.

4. Mjeku mund të pezullohet nga puna nga titullari i institucionit ku është punësuar, në rastet e parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjatë kohës së pezullimit, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet financiare.

5. Largimi nga puna i mjekut bëhet nga drejtori / titullari i institucionit sipas akteve ligjore në fuqi dhe për mjekët në institucionet në varësi të OSHKSH-së njoftohet NJVKSH-ja/DROSHKSH-ja dhe DQOSHKSH-ja.

KREU IX

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 205, datë 9.4.2024, “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës së mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet Platformës Elektronike”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria Qendrore dhe drejtoritë rajonale të OSHKSH-së, si dhe institucionet shëndetësore publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MIRËQENIES SOCIALE

Evis Sala



**KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE
TË KANDIDATËVE PËR MJEK TË PËRGJITHSHËM**

SHTOJCA 1

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvoja në punë si mjek i përgjithshëm/mjek familje (një pikë për çdo vit pune, deri në 15 vite eksperiencë pune). Njihet dhe përvoja në punë si mjek vullnetar (vërtetuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive sipas ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”).	1–15 pikë
2	Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: nota mesatare (e thjeshtë) 5.00–6.00 = 1 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 6.01–7.00 = 2 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 7.01–8.00 = 3 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 8.01–9.00 = 4 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 9.01–10.00 = 5 pikë.	1–5 pikë
3	Nota mesatare e studimeve të specialitetit, vlerësimi bëhet sipas pikës 2.	1–5 pikë
4	Dëshmi të njohjes së gjuhës/vet të huaja: Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike, 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.	0–2 pikë
5	Grada shkencore, maksimumi: 10 pikë; Studime doktorature në shëndetësi: 10 pikë; Studime master në një nga fushat e shëndetësisë: 5 pikë.	0–10 pikë
6	Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën, maksimumi 8 pikë: a) kualifikime nga 3 deri në 6 muaj: 4 pikë; b) kualifikime 6 muaj e më shumë: 8 pikë.	0–8 pikë

**KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE
TË KANDIDATËVE PËR MJEK SPECIALIST**

SHTOJCA 2

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvoja në punë si mjek specialist (do të llogariten vetëm vitet si mjek specialist pas kryerjes së specializimit; një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	10 pikë
2	Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: nota mesatare (e thjeshtë) 5.00–6.00 = 1 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 6.01–7.00 = 2 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 7.01–8.00 = 3 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 8.01–9.00 = 4 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 9.01–10.00 = 5 pikë.	1–5 pikë
3	Nota mesatare e studimeve të specialitetit, vlerësimi bëhet sipas pikës 2.	1–5 pikë
4	Dëshmi të njohjes së gjuhës/vet të huaja: Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike, 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë; Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.	0–2 pikë



5	Grada shkencore, maksimumi: 10 pikë; Studime doktorature në shëndetësi: 10 pikë; Studime master në një nga fushat e shëndetësisë: 8 pikë.	0–10 pikë
6	Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën, maksimumi 8 pikë: a) kualifikime nga 3 deri në 6 muaj: 4 pikë; b) kualifikime 6 muaj e më shumë: 8 pikë.	0–8 pikë

**KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE
PËR MJEK SPECIALIST NË SPITALET TERCIARE & UNIVERSITARE**

SHTOJCA 3

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1	Përvoja në punë si mjek specialist (do të llogariten vetëm vitet si mjek specialist pas kryerjes së specializimit; 0.5 pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune).	1–5 pikë
2	Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: nota mesatare (e thjeshtë) 5.00–6.00 = 1 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 6.01–7.00 = 2 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 7.01–8.00 = 3 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 8.01–9.00 = 4 pikë; nota mesatare (e thjeshtë) 9.01–10.00 = 5 pikë.	1–5 pikë
3	Nota mesatare e studimeve të specialitetit, vlerësimi bëhet sipas pikës 2.	1–5 pikë
4	Dëshmi të njohjes së gjuhës/vet ë huaja: Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike, 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë; Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë; Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.	0–2 pikë
5	Grada shkencore, maksimumi: 8 pikë: Studime doktorature në shëndetësi: 8 pikë; Studime master në një nga fushat e shëndetësisë: 5 pikë.	0–8 pikë
6	Diploma dhe dëshmi të tjera kualifikimesh që lidhen me fushën, maksimumi 5 pikë: a) kualifikime nga 3 deri në 6 muaj: 1 pikë; b) kualifikime 6 muaj e më shumë: 5 pikë.	0–5 pikë

SHTOJCA 4

**DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E
KONFLIKTIT TË INTERESIT**

Deklaroj në përgjegjësinë time se në procesin e konkurrimit për pozicionin mjek pranë _____ që zhvillohet në datën __.__.____, nuk jam në konflikt interesi me asnjë prej kandidaturave të paraqitura për konkurrim.

DEKLARUESI DATA



SHTOJCA NR. 5

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE
VENDIM

Për përfundimin e procedurës së konkurrimit për pozicionin _____

Në zbatim të VKM-së nr. 419, datë 4.7.2018, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor” ose (akti i krijimit të institucionit përkatës, për institucionet që nuk janë në varësi të operatorit) Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve, i krijuar në urdhrin nr. __, datë __.__.____ të (organit përkatës), zhvilloi procesin e vlerësimit të kandidatëve për pozicionin: _____

Në përfundim të procedurës, Komisioni i Vlerësimit,

VËREN:

Nga rezultatet e vlerësimit, kandidatët e kualifikuar janë:

1. Z.

2. Znj.

Në përfundim të procedurës rezultojnë se renditja e kandidatëve është sipas Raportit paraprak të datës që i bashkëlidhet këtij vendimit dhe është pjesë e tij.

Bazuar në udhëzimin nr. __, datë __.__.____, “Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës së mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”, Komisioni i Vlerësimit,

VENDOSI:

Përzgjedhjen e z./znj. _____ si kandidati i cili renditet i pari, për t’u emëruar në pozicionin: _____.

Ky vendim hartohet në dy kopje origjinale. Një kopje i përcillet për njoftim brenda 24 orëve (organit të emërtesës), një kopje administrohet në dosjen e procedurës nga njësi e burimeve njerëzore të institucionit që ngre komisionin.

Komisioni i Vlerësimit

_____ kryetar;

_____ anëtar;

_____ anëtar.

SHTOJCA NR. 6

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE
RAPORT

Datë __.__.____

Për rezultatin e procedurës së konkurrimit për pozicionin _____

Në zbatim të VKM-së nr. 419, datë 4.7.2018, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor” ose (akti i krijimit të institucionit përkatës, për institucionet që nuk janë në varësi të operatorit), Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve, i krijuar në urdhrin



nr. _____, datë _____._____._____ të (organit përkatës), zhvilloi procesin e vlerësimit të kandidatëve për pozicionin: _____

Nga rezultati në të tre fazat e konkurrimit, lista e kandidatëve të kualifikuar për të marrë pjesë në këtë fazë është:

1. Z.

Në përfundim të procedurës, bazuar në formularët për vlerësimin individual, vlerësimi dhe renditja e kandidatëve është si më poshtë:

Emri/mbiemri i kandidatit	Pikët për dokumentet e dorëzuara	Pikë për intervistën me gojë	Shuma totale e pikëve	Lista e kandidatëve sipas pikëve të marra

Ky vendim hartohet në dy kopje origjinale. Një kopje i përçillet për njoftim brenda 24 orëve (organit të emërtesës), një kopje administrohet në dosjen e procedurës nga njësisë e burimeve njerëzore të institucionit që ngre komisionin.

Komisioni i Vlerësimit

_____ kryetar;

_____ anëtar;

_____ anëtar.

SHTOJCA NR. 7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA RAJONALE

Fletë inventari

Inventari i dosjes nr. _____, i aplikimeve të thirrjes _____ Periudha e aplikimit:
(_____ deri më _____)

Afati i kryerjes së procedurave: nga data _____._____.20__ deri më _____._____.20__ Komisioni i Vlerësimit:
..... ; ;

Nr.	Emërtimi i shkresës	Nr. datë	Nr. i fletëve
1	Njoftim për shpalljen e vendit vakant		1
2	Publikimi		4
3	Procesverbal i verifikimit paraprak		
4	Ankesa/kthim përgjigje		
5	Procesverbali i verifikimit final dhe kalimi në fazën e dytë (përfshi edhe ankesat e kësaj faze)		
6	Formulari i regjistrimit më zë ose jo		
7	Procesverbali i intervistës së strukturuar		
8	Deklaratat e konfliktit të interesit		
9	Raport i vlerësimit paraprak		
10	Ankesa/kthim përgjigje		
11	Vendimi përfundimtar		
12	Dërgimi për publikim në platformë		
13	Ankesa/kthim përgjigje/refuzime		
14	Shkresa me vendimin e drejtorit		
	Dokumentacioni ndihmës		
	 etj.		
	TOTALI I FLETËVE		



Inventari përfundon me numër rendor _____

Sekretariati i platformës elektronike “Mjekë për Shqipërinë”

1. _____

2. _____

3. _____

Dorëzuesi (përgjegjësi i Sektorit) _____

Marrësi në dorëzim (Arkiva) datë, më _____

SHTOJCA NR. 8

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DREJTORIA RAJONALE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Dosja e aplikimit përmban:

Nr.	dokumentacion	Po	Jo	Nr. faqesh	I detyrueshëm
1	Jetëshkrimi i kandidatit (CV)				I detyrueshëm
2	Libreza e punës				
3	Diploma universitare dhe lista e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga ministria e përgjegjëse për arsimin				I detyrueshëm
4	Diploma e specializimit dhe lista e notave				E detyrueshme nëse pozicioni i punës është për mjek specialist
5	Leja e ushtrimit të profesionit				E detyrueshme
6	Dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor)				
7	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja				
8	Certifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim, të ndjekura brenda dhe jashtë vendit				
9	Të tjera				
10					
11					
12					
13					

Data __. __. 202__

Dorëzuesi:

Marrësi në dorëzim:



VENDIM

Nr. 91, datë 2.4.2026

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DION ENERGJI” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 667/7 prot., datë 31.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dion Energji’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dion Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667 prot., datë 17.2.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 68, datë 2.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 3.3.2026 dhe 4.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 12.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në rrjetet sociale, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 667/3 prot., datë 3.3.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667/6 prot., datë 19.3.2026, MIE është shprehur parimisht dakord për fillimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë me licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 667/4 prot., datë 3.3.2026 dhe *email*-in me nr. 667/6 prot., datë 26.3.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin informacionit/dokumentacionit të përditësuar të aplikimit.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 667/5 prot., datë 17.3.2026, dhe *email*-in e datës 26.3.2026, shoqëria ka përditësuar informacionin/dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

Shoqëria “Dion Energji” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Dion Energji’ sh.p.k.”, më datë 6.4.2023.

- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës nr. 6359/3 prot., të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., si dhe ka depozituar “Marrëveshjen e lidhjes së re”, nr. 6359/2 prot., datë 28.6.2022.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më datë 13.11.2024, për të zhvilluar projektin për



zhvillimin e projektit “Centrali diellor fotovoltaiik”, me kapacitet 2 mw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 13.11.2026, dhe duhet të fillojë punimet brenda këtij afati. Por nga ana tjetër, ajo ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda datës 15.5.2026, që është brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së përkatëse, si dhe ka argumentuar se punimet tashmë janë në fazën përfundimtare. Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 15.5.2026.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Dion Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.5.2026.

3. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Dion Energji” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 95, datë 2.4.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETJEVE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN BANK” SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të



Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 46/12 prot., datë 1.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni, si vijon:

1. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve

- Shoqëria EZ-5 Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për centralin fotovoltai me kapacitet 10 mw, me vendndodhje në Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 342, datë 23.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për marrjen e autorizimit për vendosje kolateral asetet fikse të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Procedura vijuese dhe vlerësimi i dokumentacionit

- Pas analizimit/vlerësimit të dokumentacionit të përcjellë nga ana e shoqërisë, në kuadër të aplikimit, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 67, datë 2.3.2026, vendosi të përfundojë procedurën e nisur me vendimin nr. 342/2025, në lidhje me tre kontratat e kredisë të datave 19.4.2021, 13.10.2021 dhe 24.8.2022 (pasi janë nënshkruar përpara licencimit të shoqërisë nga ERE), si dhe të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve fikse, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a., në lidhje me kontratën e kredisë nënshkruar në datën 2.9.2025.

- Për sa më sipër, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore e cila u zhvillua në datën 17.3.2026, me përfaqësuesit e shoqërisë dhe “Raiffeisen Bank” sh.a., me qëllim sqarimin e nevojës së kredisë, në kushtet kur centrali është tashmë i ndërtuar dhe ka

hyrë në prodhim, si dhe objektin për të cilin kjo kredi është dhënë.

- Në këtë seancë u trajtua pjesa e ndarjes së listës së aseteve, si dhe u bënë sqarimet përkatëse në lidhje me objektin, pasi shoqërisë i është nevojitur financim për veprimtari të tjera që nuk lidhen me atë të licencuar nga ERE, por në referencë të ligjit nr. 43/2015 dhe rregullores, duhet të bëhet ndarja e aseteve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, në kuadër të garantimit të shlyerjes së kredisë së nënshkruar më datë 2.9.2025.

- Në lidhje me sa evidentuar, nevojitet koha për korrespondencën përkatëse me shoqërinë dhe me bankën për të dokumentuar listën përkatëse të rishikuar të aseteve fikse të centralit, bashkëlidhur kontratës së kredisë, datë 2.9.2025, me anë të të cilave do të garantohet shlyerja e detyrimit kundrejt bankës financuese.

3. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim depozitimin e listës të rishikuar të aseteve fikse, referuar kontratës së nënshkruar më datë 2.9.2025, vlerësohet zgjatja me 60 (gjashtëdhjetë) ditë e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj. Shoqëria dhe banka duhet të depozitojnë këtë listë në ERE brenda 40 (dyzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Brenda 40 (dyzet) ditëve duhet të depozitohet në ERE lista e rishikuar e aseteve fikse, referuar kontratës së nënshkruar më datë 2.9.2025.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k. dhe “Raiffeisen Bank” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 96, datë 2.4.2026

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E
SHOQËRISË “SUN BEAT SYSTEM” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 730/4 prot., datë 1.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sun Beat System’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Sun Beat System” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Sun Beat System” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 21.7.2022, për centralin fotovoltai me kapacitet 2 mw me vendndodhje në Bitunckë, Bilisht, qarku Korçë.

- Shoqëria, me shkresën nr. 730 prot., datë 25.2.2026, ka paraqitur kërkesën, në lidhje me marrjen e pëlqimit për transferimin e kuotës së ortakut të shoqërisë z. I. B. (me 64% të aksioneve) dhe z. T. N. (me 36% të aksioneve), tek z. I. SH. që do të zotërojë 100% të kuotave.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- ERE, me shkresën nr. 730/1 prot., datë 9.3.2026, ka njoftuar shoqërinë mbi informacionin /dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

- Shoqëria me *email*-in e protokolluar në vijim në ERE me nr. 730/2 prot., datë 21.3.2026, ka përcjellë në formë elektronike dokumentacionin e kërkuar.

- Në vijim, ERE, nëpërmjet *email*-it të datës 26.3.2026, i ka kërkuar shoqërisë depozitimin e dokumentacionin në format original ose fotokopje të njësuar me origjinalin, të cilën shoqëria e depozitoi nëpërmjet shkresës me nr. 730/3 prot., datë 26.3.2026.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Sun Beat System” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë dhe/ose përfaqësuesit ligjor të autorizuar me prokurë.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – shoqëria kërkon që të mbahet konfidencial i gjithë dokumentacioni i depozituar në ERE dhe të mos jetë i hapur për publikun duke qenë se përmban informacion sensitive për konkurrentët.

Pavarësisht kërkesës së shoqërisë për konfidencialitetin tërësor të dosjes, ERE, në zbatim të “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit për të



identifikuar konkretisht dokumentet apo pjesët e dokumentacionit që trajtohen si konfidenciale, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, duke qenë se përmbajnë të dhëna identifikuese të personave fizikë, si dhe informacione të aktivitetit tregtar, justifikojnë trajtimin si konfidencial, dokumentacioni si vijon:

- Shkresa e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., datë 25.2.2026, me lëndë: “Kërkesë për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortaku/ aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, nëpërmjet shitjes, dhurimit, trashëgimisë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të kuotave apo aksioneve të të licencuarit” dhe shkresa e datës 21.3.2026, me lëndë: “Plotësim dokumentacioni dhe kthim përgjigje shkresës nr. 730/1, datë 25.2.2026 (do të konsiderohen konfidenciale të dhënat personale të administratorit, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë);

- Fotokopje e noterizuar e regjistrit të barrëve siguruese (ky dokument do të konsiderohet si konfidencial, duke qenë se përmban të dhëna sensitive të shoqërisë, si dhe informacione mbi aktivitetin tregtar të shoqërisë).

Nga ana tjetër, do të konsiderohet dhe trajtohet si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me karakter deklarativ/informues dhe/ose është e depozituar apo e aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

- Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k. (ky dokument do të konsiderohen si jokonfidenciale, në rrethanat që janë të publikuara dhe të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret QKB);

- Kontratë shitjeje pasuri e luajtshme (kuota kapitali) me nr. 1237 rep., nr. 621 kol., datë 24.2.2026, kontratë shitjeje pasuri e luajtshme (kuota kapitali) me nr. 1235 rep., nr. 619 kol., datë 24.2.2026 (këto dokumente do të konsiderohen si jokonfidenciale, por me redaktim selektiv, për arsye se konsiderohen si dokumente me natyrë juridike deklarative dhe lidhet me ndryshimin e pronësisë së kuotave, informacion i cili reflektohet dhe në regjistrin tregtar);

- Vendimi i datës 22.12.2025, i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Sun Beat System” (SBS) sh.p.k.; vendimi nr. 2, i datës 10.3.2026, i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Sun Beat System” (SBS) sh.p.k. (këto dokumente do të konsiderohen

jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale);

- Deklarata e administratorit, të datës 18.3.2026, mbi kuotat/aksionet e shoqërisë që nuk janë vendosur si mjete për garantimin e ndonjë detyrimi tjetër ndaj të tretëve dhe deklarata e datës 18.3.2026, mbi vullnetin për të kthyer kuotat në gjendjen e mëparshme në rast të mosmarrjes së miratimit të ERE-s (këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, që lidhen me organizimin dhe vendimmarrjen e shoqërisë. Ato nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare dhe personale);

- Deklarata noteriale e datës 18.3.2026, e ortakut tek i cili do të transferohen kuotat e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., me anë të së cilës shpreh gatishmërinë për të vazhduar aktivitetin e licencuar edhe pas transferimit të kuotave (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, por me redaktim selektiv të elementeve që kanë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale).

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë;

- Pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa “c” – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., datë 10.2.2026, nëpërmjet të cilit është miratuar shitja e kuotës;

- germa “d” – marrëveshjet paraprake përkatëse:

- “Kontratë shitje pasuri e luajtshme (kontratë shitje kuote)” me nr. 1235 rep., nr. 619 kol., datë 24.2.2026, nënshkruar midis palëve, me anë të së cilës është dakordësuar transferimi i kuotës nga



ortaku aktual z. T. N. (i cili zotëron 36% të kuotës së kapitalit të shoqërisë) tek z. I. Sh;

- “Kontratë shitje pasuri e luajtshme (kontratë shitje kuote)” me nr. 1237 rep., nr. 621 kol., datë 24.2.2026, nënshkruar midis palëve, me anë të së cilës është dakordësuar transferimi i kuotës nga ortaku aktual z. I. B. (i cili zotëron 64% të kuotës së kapitalit të shoqërisë) tek z. I. Sh.;

- Pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2021, vlen të sqarojmë se shoqëria ka një veprim tashmë të ezauruar/pasqyruar, si e tillë nuk lind e nevojshme të mbahet në konsideratë në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., sipas strukturës së kërkuar, për 100% të kuotave të kapitalit të z. I SH.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto palë.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast se nga MIE depozitohet një qëndrim ndryshe, në lidhje me detyrimet që i burojnë shoqërisë nga kontrata e nënshkruar më datë 7.6.2022 apo çdo akt tjetër i ndryshuar që i ka shërbyer kësaj vendimarrjeje.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “Sun Beat System” sh.p.k. dhe Ministrinë e

Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 97, datë 2.4.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” SHPK, DEGA NË TIRANË, PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË ORIGJINËS

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës me nr. 725/2 prot., datë 1.4.2026, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Future Energy Trading and Exchange Dynamics’ sh.p.k., dega në Tiranë, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”, konstatoi se:



1. Të dhëna mbi shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 118, datë 24.5.2025, ka miratuar njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike me nr. ZRRE/LI_72/21, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1400_2021, datë 2.9.2021, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. (Fuente Dynamics), që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë. Njohja e licencës është e vlefshme deri më 1.9.2026.

- Gjithashtu, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 4.7.2023, ka miratuar njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/LI_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 5.5.2023, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë. Njohja e licencës është e vlefshme deri më 12.4.2028.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, me anë të *email*-it datë 30.3.2026, protokolluar në ERE me nr. 725/1 prot. datë 30.3.2026, ka paraqitur në ERE kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.

- Shoqëria ka përcjellë të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të rregullores, pikën 4.1, duke specifikuar të dhënat identifikuese.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistrin elektronik

të garancive të origjinës, si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, për tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k., dega në Tiranë, lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 166, datë 12.6.2026

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN MAJ 2026, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe të nenit 15, të “Rregullores për



organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.6.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1768/1 prot., datë 4.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv”,

konstatohet se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga “FSHU” sh.a.

Shoqëria “FSHU” sh.a., me shkresën nr. 3685 prot., datë 1.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1768 prot., datë 2.6.2026, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin maj 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin maj 2026, “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokuruar, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, “FSHU” sh.a. ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin maj 2026 në vlerën 10.28 lekë/kwh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 10.28 lekë/kwh, në përputhje me përlogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë, si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin prill 2026: 9.01 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 312, datë 12.12.2025, “Mbi lënie në fuqi deri më 30 prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike” të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022: 1.55 lekë/kwh;

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor 30.4.2026–29.5.2026.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2026, përlogaritet si më poshtë:



Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin maj 2026

		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	10.28
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.31
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	14.05

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton **14.05 lekë/kwh për muajin maj 2026**.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2026 prej 14.05 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 167, datë 15.6.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “DOMA GROUP” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/1 prot., datë 10.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Doma Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Doma Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrale “Vinjollë 1”, me kapacitet të instaluar 1.840 mw, me vendndodhje në përrrenjtë e



Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b”, “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezultojnë se shoqëria “Doma Group” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontratën nr. 641 rep., nr. 186/2 kol., datë 27.12.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Vinjoll 1’ me kapacitet prodhues 1.840 mw, në përrenjtë e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë të përroit Zall i madh, Bashkia Mat, qarku Dibër”;

- Është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes së HEC “Vinjoll 1” me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSHEE sh.a. nr. 14690/3 prot., datë 25.7.2018, për kapacitetin 1860 kw. Shoqëria është e detyruar që të operojë brenda kapacitetit 1.840 mw të miratuar nga MIE;

- Është pajisur me lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 39 prot., datë 26.12.2023, me nr. serial 000106, të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Mat, me afat vlefshmërie deri më 26.12.2028;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake nr. AN230520230011, lëshuar më 21.9.2023, Komisioni 96, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtim HEC ‘Vinjoll 1’”, me kapaciteti të instaluar 1.840

mw përfshirë edhe lejen e ndërtimit për objektin “Ndërtimi i hidrocentralit ‘Vinjoll 1’”.

Në kuptim të nenit 9 pikat 1. 3 germat “a”, dhe “b”, si dhe pika 2.1”, germat: “a”, “b”, “d”, dhe “e”, për qëllime të këtij aplikimi shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:

Neni 9

1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a”:

- vërtetimin të përditësuar për shlyerjen e detyrimeve tatimore;

- vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (që nuk rezultojnë të jetë depozituar në këtë aplikim);

- germa “b”: Në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 2 të kontratës, duhet të depozitohet në ERE miratimin përkatës të MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit. Po ashtu, duhet të depozitohet dokumentacion që vërteton aftësinë financiare të saj për realizimin e projektit.

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitohet, gjithashtu:

- germa “a”: Shoqëria duhet të paraqesë të dhënat, në lidhje me vitin e ndërtimit të centralit, datën në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit;

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitohet raportimet e dërguara në MIE, në kuadër të ecures së projektit, si dhe të përditësojë çdo informacion/dokumentacion vijues në lidhje me zhvillimin e tij;

- germa “d” Shoqëria duhet të depozitohet vendimin e KBU-së Mat dhe lejen për përdorimin e burimit ujqor në format origjinal ose fotokopje e njëjësuar me origjinalin;

- germa “e”: Shoqëria duhet të japë informacion, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Doma Group” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjoll 1”, me kapacitet të instaluar 1.840 mw, me vendndodhje në përrenjtë e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Doma Group” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 168, datë 15.6.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GLOBAL INTERPRISE
GROUP” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin e ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1722/1 prot., datë 10.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Interprise Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “c” dhe “d”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “c”;

- Në përputhje me nenin 9, pika 2, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b”, “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezulton se shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën nr. 642 rep., nr. 1977 kol., datë 27.12.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Doma” me kapacitet prodhues 1.695 mw, në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër”;

- Është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes së HEC “Doma” me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSHEE sh.a. nr. 1491/2 prot., datë 25.7.2018, me lëndë “Miratim pikë lidhjeje HEC ‘Doma’, për një kapacitet të instaluar prej 1695 kw”;

- Është pajisur me lejen për përdorim burimi ujor sipërfaqësor nr. 40 prot., datë 26.12.2023, me nr. serial 000107, të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Mat, me afat vlefshmërie deri më 26.12.2028;



- Është pajisur me vendim për VNM paraprahe nr. AN230620230002, lëshuar më 7.9.2023, komisioni 96, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtim HEC ‘DOMA’”, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër, me kapaciteti të instaluar 1695 kw, përfshirë lejen e ndërtimit për objektin “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit ‘Doma’”,

Në kuptim të nenit 9, pika 1.2, germa “b”, pika 1.3, gjerat “a” dhe “b”, si dhe pika 2.1, gjerat “a”, “b”, dhe “e”, për qëllime të këtij aplikimi shoqëria duhet të plotësojë dhe sa vijon:

Neni 9. Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Dëshminë e penalitetit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për vetë shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera, në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “b”: Në referencë të përcaktimeve të nenit 8, pika 2 të kontratës, duhet të depozitojë në ERE miratimin përkatës të MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit.

Po ashtu, duhet të depozitojë dokumentacion që vërteton aftësinë financiare të saj për realizimin e projektit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës:

2.1 germa “a”, germa “b” dhe germa “e”:

- të dhënat në lidhje me vitin e ndërtimit të centralit, datën në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit;

- raportimet e dërguara në MIE, në kuadër të ecurisë së projektit, si dhe të përditësojë çdo informacion/dokumentacion vijues, në lidhje me zhvillimin e tij;

- informacion, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Global Interprise Group” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw,

me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 169, datë 15.6.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1564/2 prot., datë



10.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1564/1 prot., datë 26.5.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 492, seria F21, është 2.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 2.6.2026.

- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/depozitojë dhe sa vijon:

- informacion mbi stafin teknik aktualisht efektiv;

- vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- dëshminë e penaltetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj;

- mbështetjen financiare për vlerën e mbetur për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregutit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike, dhe vendimin e organeve drejtuese për dedikimin

përkatës të shumës për secilën veprimtari sipas përlllogaritjeve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 492, seria F21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 2.12.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 170, datë 15.6.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e



Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1565/2 prot., datë 10.6.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 2.12.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1565/1 prot., datë 26.5.2026.

- Në nenin 16, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 493, seria T21, është 2.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 2.6.2026.

- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se shoqëria duhet të sqarojë/depozitojë dhe sa vijon:

- informacion mbi stafin teknik aktualisht efektiv;
- vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të papaguara ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj;

- mbështetjen financiare për vlerën e mbetur për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike dhe vendimin e organeve drejtuese për dedikimin përkatës të shumës për secilën veprimtari sipas përlogaritjeve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 493, seria T21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 2.12.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 171, datë 15.6.2026

**MBI MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 197, DATË
15.8.2025, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘KËLCYRA 2020’ SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
‘KLISYRË’, ME KAPACITET PRODHUES
2 mw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve, 77–89 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 85/7 prot., datë 11.6.2026, si dhe informacionin shitesë me nr. 85/8, datë 12.6.2026, të përgatitura nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Këlcyra 2020’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Klisyrë’, me kapacitet prodhues 2 mw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 197, datë 15.8.2025, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Këlcyra 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë, për një afat 30-vjeçar.

- Në dispozitivin e vendimit nr. 197/2025, ERE, gjithashtu, ka vendosur ndër të tjera detyrimin për shoqërinë që përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, për kapacitetin 2 mw, si dhe të dokumentojë në ERE ndërtimin dhe vënien në punë të HEC-it brenda datës 31.12.2025.

- Po ashtu me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet

të dokumentojë në ERE testimin e veprës si dhe brenda datës 1.1.2026, duhet të depozitojë marrëveshjen e rinovuar për shërbimet e kontabilitetit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038/10 prot., datë 20.8.2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka bërë me dije se shoqëria ka kërkuar pajisjen me faturën e pagesës sipas VKM-së nr. 822/2025, të ndryshuar, për marrjen e miratimit përfundimtar për zgjerimin e kapacitetit të HEC “Këlsyrë” dhe me shkresën nr. 2462/1 prot., datë 24.4.2025, ajo ka sqaruar shoqërinë se, referuar pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar me ligjin nr. 61/2020, miratimi për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë bëhet nëpërmjet procesit konkurrues. Në fund të shkresës MIE sjell në vëmendje të ERE-s se nuk ka miratuar zgjerimin e kapacitetit të HEC-it ekzistues “Këlsyrë”.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë dhe MIE-n, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 288, datë 13.11.2025, vendosi fillimin e procedurës për rishikimin e vendimit nr. 197/2025, me qëllim vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme që lidhen me aplikimin shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe objektin e kërkesës së këtij aplikimi.

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s të datës 12.12.2025, u referua informacioni nr. 2038/21 prot., datë 12.12.2025 dhe u konstatua se ishte e paqartë nëse shoqëria kishte paraqitur aplikim pranë MIE-s dhe ky ishte refuzuar nga ana e saj apo shkresa e MIE-s drejtuar shoqërisë dhe ato në vijim drejtuar ERE-s, referonin vetëm legjislacionin përkatës në fuqi për ndjekjen e një procedurë të tillë.

- Në lidhje me sqarimin e rrethanave sa më sipër, u planifikuan disa seanca dëgjimore, ku për seancën dëgjimore të datës 9.12.2025, është lajmëruar shoqëria me shkresën nr. 2038/19 prot., datë 21.11.2025, dhe me *email-in* e datës 3.12.2025. Ndërsa për seancën dëgjimore të datës 24.2.2026, të planifikuar të zhvillohej me përfaqësues të MIE-s dhe shoqërisë, janë dërguar shkresat nr. 2028/23 prot., datë 22.12.2025, nr. 85/1 prot., datë 14.1.2026, dhe shkresa nr. 67/1 prot., datë 18.2.2026. Në seancat e planifikuara nga ERE nuk janë paraqitur as përfaqësues nga MIE dhe as nga shoqëria.

- Ndërsa me shkresën nr. 627 prot., datë 12.2.2026, shoqëria “Këlcyra 2020” sh.p.k. ka kërkuar informacion mbi vlefshmërinë e licencës.



ERE, me shkresën nr. 627/1 prot., datë 18.2.2026, ka sqaruar shoqërinë, se sikurse është në dijeni, licenca e miratuar me vendimin nr. 197/2025 përmbante kushte të posaçme, të paplotësuara nga shoqëria, veçanërisht kushtin për fillimin e operimit të centralit.

- Për gjithë sa më sipër dhe me qëllim përfundimin e procedurës së nisur me vendimin nr. 288/2025, ERE, me shkresën nr. 85/3 prot., datë 24.3.2026, ka kërkuar nga MIE një qëndrim përfundimtar nëse shoqëria kishte paraqitur aplikimin për zgjerimin e kapacitetit dhe nëse ekzistonte një vendimarrje përfundimtare në lidhje me këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 85/4 prot., datë 7.5.2026, MIE ka konfirmuar se qëndrimi i saj mbetet i pandryshuar dhe se, bazuar në pikën 2 të nenit 49 të ligjit nr. 43/2015, të ndryshuar, miratimi për ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të energjisë bëhet vetëm nëpërmjet procesit konkurrues. Ky qëndrim i është vënë në dispozicion dhe shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 85/5 prot., datë 15.5.2026.

- Gjithashtu, evidentohet se shoqëria nuk ka përmbushur kushtet e vendosura në vendimin nr. 197/2025, pasi nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar pranë ERE-s dhe nuk është paraqitur në seancat dëgjimore.

- Fillimi i efekteve juridike të vendimit nr. 197/2025 ishte i kushtëzuar me depozitimin e lejes së përdorimit të burimit ujor, dokument i cili nuk rezulton të jetë depozituar, ndaj kushti ndalues mbetet në fuqi dhe licenca nuk ka filluar ende efektshmërinë e saj.

- Së fundi, në ERE është depozituar shkresa e shoqërisë “Këlcyrë 2020” sh.p.k., protokolluar me nr. 85/6 prot., datë 11.6.2026, me anë të së cilës shoqëria shprehet se do t'i drejtohet MIE-s për ish-HEC Këlcyrë, pasi nuk është me koncesion, por është privatizuar dhe se mbetet në dispozicion të ERE-s për të ofruar çdo dokumentacion ose sqarim të mëtejshëm që mund të nevojitet, por nuk rezulton që bashkëlidhur të jetë depozituar ndonjë dokument që të afektojë këtë vendimarrje.

- Aktualisht, pas marrjes së qëndrimit të MIE-s, dokument që nuk disponohet në momentin e licencimit, si dhe në mungesë të argumenteve, apo dokumenteve shtesë nga shoqëria dhe për shkak të mospjesëmarrjes së saj në seancat dëgjimore, vlerësohet se jemi në kushtet e rishikimit të vendimit

nr. 197/2025, ku pika 6 e tij parashikon rishikimin në rast të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara apo depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e vendimit, dhe konkretisht ndryshimin e pikës 1 të tij, duke refuzuar kërkesën e shoqërisë për licencim. Me ndryshimin e vendimit si më sipër vlerësohet se pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 të vendimit shfuqizohen.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi kompetent me një akt të ri me shkrim.

- Me ndryshimin e këtij vendimi, licenca dhe çdo akt tjetër i nxjerrë në zbatim të tij bëhen të pavlefshme.

- Në nenin 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në nenin 4, pika 3, germa “b”, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se prodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar me kapacitet të instaluar deri në 1 mw nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025, si vijon:

a) Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 15.8.2025, ndryshon dhe bëhet:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “Këlcyrë 2020” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë, për një afat 30-vjeçar.

b) Pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6 të vendimit nr. 197, datë 15.8.2025, shfuqizohen.

2. Me ndryshimin e vendimit si më sipër, licenca dhe çdo akt tjetër i dalë në zbatim të tij bëhen të pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Këlcyrë 2020” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës



dhe Energjisë, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALEPX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 172, datë 15.6.2026

**MBI HEQJEN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË
SHOQËRISË “KORKIS-2009” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, germa “ç”, dhe nenit 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 6.1, germa “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.6.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 614/3 prot., datë 11.6.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës “Mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Korkis-2009’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Korkis-2009” sh.p.k. është pajisur me licencën nr. 119, seria PV11K, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.3.2011, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Belesova 1” me fuqi 0.150 mw dhe HEC “Belesova 2” me fuqi 0.280 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 37, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e kësaj licence, për shkak se shoqëria nuk kishte shlyer në afat pagesën rregullatore të vitit 2025 ndaj ERE-s, duke rezultuar debitore për këtë pagesë, si dhe nuk ka përcjellë në ERE sqarime/ dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit.

- Për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37/2026, ERE ka njoftuar dhe MIE-n, nëpërmjet shkresës nr. 614/1 prot., datë 25.3.2026, ku i ka kërkuar, gjithashtu, qëndrimin e saj në referencë të përcaktimeve të nenit 42, pika 3, dhe 5 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, për zbatimin e masës së përkohshme më të përshtatshme dhe më të efektshme për të siguruar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në rast të heqjes së kësaj licence. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Në rrethanat kur nga ana e shoqërisë nuk kishte asnjë reagim në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës është telefonuar në numrin që ERE disponon, nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë është bërë me dije se HEC-i nuk prodhon më energji elektrike dhe për këtë fakt ka lajmëruar Ministrinë, duke i kërkuar zgjidhjen e kontratës së koncesionit. Nga ana e ERE-s është sqaruar se i licencuari nuk e ka njoftuar ERE-n për këtë fakt në kohë, në mënyrë që kjo të vlerësohej dhe në kuadër të caktimit të pagesës rregullatore përkatëse, si e tillë tashmë pagesa rregullatore është bërë titull ekzekutiv dhe duhet të vijohet me shlyerjen e saj.

- Në vijim me shkresën e saj nr. 403 prot., datë 3.4.2026, protokolluar në ERE me nr. 614/2 prot., datë 3.4.2026, shoqëria ka bërë me dije, ndër të tjera, se nuk e ushtron veprimtarinë e licencuar dhe ka dokumentuar se është në proces gjyqësor me MIE-n për zgjidhjen e kontratës së koncesionit.

- Për gjithë sa më sipër, në rrethanat kur shoqëria vetë ka bërë me dije dhe ka dokumentuar në ERE se ka paraqitur kërkesëpadinë në Gjykatë për zgjidhjen e kontratës së koncesionit, për shkak të mosushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i, vlerësohet të vijohet me heqjen e licencës.



- Në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 5, germa “ç”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe në pikën 6.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, parashikohet, se: “ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE”.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer debinë përkatëse për vitin 2025, si dhe pagesën rregullatore të vitit 2026 (miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 26.2.2026), si dhe kamatëvonesat, detyrim ky që i ka lindur shoqërisë, ndërkohë që ishte e licencuar nga ERE. Vjelja e këtyre detyrimeve do të bëhet me rrugë gjyqësore, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Në nenin 37, pika 6, gema “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në nenin 4, pika 3, germa “b”, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se prodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar me kapacitet të instaluar deri në 1 mw nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 119, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Korkis-2009” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.3.2011.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca nr. 119, seria PV11K, bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Korkis 2009” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 352 lekë



||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË||Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 136|Datë: 30.06.2026 14:20:38
+02:00|c379ae21-de60-4b46-b198-2888f095f6b4

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)